




Pozita e dijetarëve
sipas
Imam Khomeinit

Tiranë, 2018

Titulli: *Pozita e dijetarëve sipas Imam Khomeinit*

E përktheu: **Vullnet Merja**

Recensues: **Sabrie Feza**

E redaktoi: **Jerida Kulla**

E korrekttoi: **Vjollca Karaj**

Përgatiti për shtyp & Kopertina: **Sabrie Feza**

Botoi: **Shoqata "FLLADI"**

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

PARATHËNIE

Prej Imamit të nderuar (*Zotit qoftë i kwnaqur me të!*) transmetohet: “Po të mos kishte prej atyre dijetarëve që do të qëndronin dhe do të rezistonin fort pas mungesës së Imamit (*Zotit qoftë i kwnaqur me të!*); po të mos kishte prej atyre dijetarëve, që do t’u tregonin njerëzve rreth tij, prej atyre që do t’i ftonin njerëzit për te ai, prej atyre që u tregojnë njerëzve dhe u sqarojnë atyre argumentet e Allahut të Madhëruar; po të mos kishte prej atyre që i mbrojnë të varfrit dhe përpiqen t’i shpëtojnë ata prej rrjetave të Iblisit, prej atyre që përpiqen t’i shpëtojnë njerëzit prej kurthit të armiqve, nuk do të kishte mbetur njeri mbi tokë, përveçse do të kishte hequr dorë prej fesë së Allahut.”¹

¹ “Mizanul Hikmeh”, vëll 3, f. 2087.

“Po të mos kishin qenë këta dijetarë, Islami do të fshihej nga faqja e tokës. Ata janë ekspertët e Islamit. Ata janë njerëzit e ndershëm dhe të ditur, që kanë marrë në mbrojtje Islamin prej kurtheve të armiqve të tij të shumtë. Vazhdimësia e tyre është vazhdimësi për ekzistencën e Islamit.”²

Imam Khomeini (Zotit qoftë i kwnaqur me të!)

² Prej fjalimit të shkëlqesisë së tij (Imam Khomeinit), më, 08.09.1981., në një takim të tij me një grup dijetarësh nga prefektura e Horasanit. “Sahifet Nur”, vëll. 15, f. 150.

HYRJJE

Nën hijen e kapitalizmit të egër e zullumqar dhe të komunizmit ateist ekstremist, bota u nda në dy kampe të kundërta, në Kampin Perëndimor dhe në atë Lindor. Që prej asaj dite, është e natyrshme, që secila prej lëvizjeve të reja politike të përballlet me pyetjen: Cili prej dy kampeve politike dhe ideologjike i përket, Kampit Perëndimor apo Kampit Lindor?! Këto dy kampe kanë mundur ta ndajnë botën në dy kampe, me interesa diametralisht të kundërta. Secila pjesë e botës dhe e njerëzimit është e detyruar të jetojë në njërin prej këtyre dy kampeve. Kjo është strategjia e përdorur prej tyre, për të realizuar qoftë dhe në mënyrë relative qëllimin e tyre përfundimtar.

Surpriza e madhe ndodhi, kur doli një burrë i mençur, nga qyteti i Kunit (Iran), madje nga shkolla më e famshme e dijeve fetare (El Hauzeh El Ilmijeh). Doli në skenë burri që mbante mbi kokën e tij atë çallmë të zezë dhe e mbulonte trupin me rroba modeste. Doli për t'i treguar botës idetë e tij origjinale dhe flamurin e reformës rrënjësore. Ai ishte Imami Ruhullahu El Musauij El Khomeini (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*).

Imam Khomeini doli në skenë për të shembur dhe për të shkelmuar njëherë e përgjithmonë normat dhe zakonet e këqija që ishin bërë pjesë e zakoneve normale të njerëzve. Imami i nderuar doli me parullën e tij të madhe dhe me sloganin e tij të famshëm: “La sherki-je ue la garbi-je”-“As Lindje, as Perëndim!”. Ai ishte Imami i madh, koka e të cilit ka qenë gjithmonë e mbuluar me çallmën e tij të zezë dhe trupi i tij nuk ka veshur tjetër veç rrobës së dijetarëve. Ai ishte Imami që refuzoi hapur dhe fuqimisht qëndrimin nën tutelën e njërit prej kampeve politike e ideologjike. Ai refuzoi të ishte nën tutelën e Lindjes, me të njëjtën fuqi me të cilën refuzoi të qenit edhe nën tutelën e Perëndimit.

Çallma e tij e zezë dhe hija e saj e rëndë, ishte përcjellëse e kuptimeve të mëdha për Imamin e nderuar (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*). Ajo është përkufizimi më i saktë dhe më i shkurtër i tërësisë së frymës, me të cilën ai kishte ardhur, i frymës që ai kishte për synim të përcjellë.

Fryma e vërtetë e mesazhit të tij ishte Islami. Imami i nderuar citohet që të ketë thënë: “Çallma është Islami vetë.”³

³ “Sahifetun Nur”, vëll. 21, f. 93.

Është plotësisht e vërtetë se me mbrojtjen e kësaj feje dhe të Kur'anit merret vetë Krijuesi i Gjithësisë. Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin Famëlartë:

"إِنَّا نَحْنُ نَزَّلْنَا الذِّكْرَ وَإِنَّا لَهُ لَحَافِظُونَ"

“Ne e kemi zbritur (dhikrin) Kur'anin dhe po Ne do ta marrim në mbrojtje atë.” Më e rëndësishme se gjithçka është që Kur'ani Famëlartë të ruhet i memorizuar në mendje, të memorizohet në zemrat e tyre, frikë ndaj Allahut, përkushtim dhe të përkthehet te punët e tyre, metodikë dhe veprim në terren. Ky ishte qëllimi përfundimtar i Imam Khomeinit (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*). Misioni i tij i shenjtë ishte të ofrojë për mbarë botën Islamin e vërtetë, Islamin e ndritur, në të gjitha dimensionet që përfaqëson ai.

Synojmë dhe shpresojmë që, nëpërmjet këtyre fletushkave modeste, të trajtojmë një çështje që e vlerësojmë si të rëndësishme për t'u njohur me të dhe ajo është: *Pozita e dijetarëve në mendimin e Imam Khomeinit (Zoti qoftë i kënaqur me të!)*.

Përse dijetarët?

Kemi përzgjedhur dijetarët jo krejt rastësisht, pasi shoqëritë tona prej një kohe të gjatë kanë rënë viktimë e robërisë së disa mendimeve dhe ideve shumë të dëmshme perëndimore e lindore, të cilat janë importuar në shoqërinë tonë dhe kanë hedhur rrënjët thellë aty, në emër të përparimit, të modernitetit dhe të zhvillimit.

Një nga kuptimet më qëllimiga, të importuara te shoqëritë tona është fjala “njeri i fesë”, që do të thotë se dijetarët e fesë duhet të merren vetëm me aspektin shpirtëror të Islamit dhe me asgjë më shumë. “Njerëzit/burrat e fesë” nuk mund dhe nuk duhet të merren me çështjet e politikës, të ekonomisë dhe të drejtësisë, sepse ashtu si në kristianizëm, duhet të mbështeten në teorinë e laicizmit që thotë: “Jepi Zotit, atë që i takon Zotit dhe jepi Cezarit, atë që i takon Cezarit.”

Një pjesë e madhe e njerëzve, nuk tregohen të kujdesshëm dhe, pa dashur, bien viktimë të këtyre botëkuptimeve, që janë realisht të huaja për Islamin e vërtetë dhe thelbin e mesazhit të tij. Disa njerëz, edhe pse e pranojnë me gojën e tyre, se i refuzojnë koncepte dhe kurthe të tilla, i praktikojnë të njëjtat mendime në mënyrë të pavullnetshme. Kjo ndodh sa herë që ata i nënvlerësojnë

dhe nuk u japin rëndësinë që meritojnë dijetarëve dhe hoxhallarëve të nderuar, duke i konsideruar ata njerëz të dorës së dytë. Në mënyrë të pavetëdijshme, ata janë thellësisht të bindur se roli i këtyre hoxhallarëve dhe njerëzve të fesë është i lidhur posaçërisht me çështje që i përkasin adhurimeve dhe detajeve të lidhura me fenë.

Imam Khomeini (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) ka paralajmëruar vazhdimisht rrezikun e nënvlerësimit dhe të mënjanimi të dijetarëve prej jetës publike të njerëzve dhe në njërin prej fjalimeve të tij është shprehur:

“Armiqtë e Islamit hedhin baltë dhe flasin keq rreth Islamit dhe njerëzve të fesë, që mbajnë çallma në kokë, sepse hallin më të madh që kanë dhe pengesa e tyre më e madhe është Islami vetë. Kjo ndodh, sepse ata që kanë çallma në kokat e tyre, duan që shteti të zbatojë ligjin e sheriatit. Ata refuzojnë dhe përdorin të gjitha rrugët që ky qëllim të mos realizohet kurrë. Synimi i tyre kryesor është mënjanimi i fesë dhe i dijetarëve të fesë prej çështjeve të ditës, në mënyrë që njerëzit të ftohen sa më shumë me Islamin. Kjo është e vetmja mënyrë që ata të mbajnë të hapur rrugën për realizimin e planeve dhe të synimeve të tyre.”⁴

⁴ Pjesë e një fjalimi të mbajtur prej Imamit të nderuar, në të cilin demaskohet roli i Shahut të Iranit, në lehtësimin dhe në hapjen e rrugës për planet e kolonizatorëve dhe pushtuesve të vendit.

Përse dijetarët janë në mendimin e Imam Khomeinit (Zoti qoftë i kënaqur me të!)?!

Kjo ndodh, sepse Imam Khomeini (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) ishte përfaqësues i atyre mjediseve, i asaj fryme dhe i asaj shkolle. Ai e kishte kaluar një pjesë të madhe të viteve të jetës së tij pranë atyre mjediseve dhe prej fëmijërisë së tij të hershme ishte formuar aty. Ai ishte njëri prej nxënësve të hauzes/shkolla islame e dijeve. Me kalimin e viteve ka dhënë mësim në atë shkollë dhe ka drejtuar njërën prej (hauzeve) shkollave më të rëndësishme në vend. Të gjitha këto kanë ndodhur përpara se të bëhej “merxha’a” - “autoritet i lartë fetar”, që konsiderohet si pikë reference në dije dhe në shkencat e fesë. Ky është një pozicion që e shndërron atë më pas në bërthamën e (hauzes) dhe padyshim që e furnizon atë me një rol shumë qendror. Imami i nderuar, kur flet rreth historisë së tij, thotë:

“Unë jam sot një tetëdhjetë vjeçar, që kam kaluar përafërsisht gjashtëdhjetë vite të jetës në rrethet shkencore dhe akademike dhe rreth tridhjetë vite i kam kaluar brenda në terren. Për këtë arsye, mund të them se kam parë shumë

në jetën time dhe kam krijuar konceptet e mia rreth çështjeve të ndryshme në jetë.”⁵

Duke qenë se Imam Khomeini (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) ka qenë zotërues i një shikimi dhe depërtimi meditues të thellë, ka pasur mundësinë të shohë përtej dimensionit sipërfaqësor të ngjarjeve dhe të zhvillimeve. Ai ka qenë njëri prej atyre që e ka parashikuar rënien, rrënimin dhe rrëzimin e Bashkimit Sovjetik. Një njeri i aftë, të depërtojë thellë ngjarjeve më të rëndësishme gjeopolitike të kohës dhe të bëjë parashikime të tilla largpamëse, është i aftë njëkohësisht të njohë realitetin e (hauzes së dijes) dhe të dijetarëve të përfshirë në të. Ai është i aftë të përkufizojë me saktësi të madhe rolin e rëndësishëm të dijetarëve.

Ai është njohës i mirë i detajeve dhe i imtësive të lidhura me ta, pasi ai ka kaluar një pjesë të madhe të jetës në mesin e tyre, madje ai vetë është njëri prej tyre.

Imam Khomeini (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) është shëmbëlltyrë dhe reflektim i qartë i Islamit të vërtetë muhamedan në mesin e umetit islam (popullit islam) në ditët e sotme. Fjala e tij nuk është, thjesht, përfaqësuese e mendimeve të tij personale, por është përfaqësuese e dritës islame, e përfaqësuar në dijen e tij të madhe dhe me transmetimin me kompetencë të shkencave fetare, që

⁵ Prej fjalimit të shkëlqesisë së tij, 30.11.1977., pas martirizimit të djalit të tij, Es Sejid Mustafa. “Sahifet Nur”, vëll. 1, f. 258.

burojnë nga pozita e tij e lartë dhe e veçantë si (muxhtehid/autoritet i lartë në lëmin e dijeve të fesë). Ai ka qenë një personalitet shumë i rëndësishëm i dijes dhe i shkencës, gjë që e ka dëshmuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të pandërprerë nëpërmjet këndvështrimeve të tij të mprehta dhe analizave të thella dhe depërtuese të ngjarjeve më të rëndësishme të kohës. Ai ka qenë, pa diskutim, një udhëheqës i madh dhe i vërtetë. Ky është një fakt kokëfortë, që e dëshmon historia vetë.

KAPITULLI I PARË

POZITA E DIJETARËVE

Imami i nderuar (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) **i cilëson**
kështu dijetarët:

“Ata dijetarë të nderuar janë paraqitja e Islamit, janë reflektimi i fytyrës së tij të vërtetë. Ata janë sqaruesit dhe komentuesit e Kur’anit Famëlartë për të gjithë njerëzimin. Ata janë reflektimi më i përafërt i mundshëm i Profetit të Islamit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*).”⁶

Dijetarët e nderuar kanë një pozitë të veçantë në mendimin e Imam Khomeinit (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*). E si mund të ndodhte ndryshe?! Ai është njëri prej thirrësve kryesorë për në rrugën e Profetit të nderuar (*Paqja dhe*

⁶ Shkëputur prej një fjalimi të mbajtur prej shkëlqesisë së tij, datë 23.12. 1978., duke folur rreth faktorëve që ndikuan në triumfin e Revolucionit Islamik. “Sahifet Nur”, vëll. 4, f. 93.

begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!), duke thënë kështu:

“Përparësia e dijetarëve ndaj pjesës tjetër të njerëzve është si përparësia e Profetit ndaj pjesës tjetër të pasuesve (ymetit) të tij.”⁷

Këtë mendim pozitiv rreth dijetarëve të nderuar, Imam Khomeini (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) e ka dhënë vazhdimisht dhe sa herë që i është dhënë rasti. Le të sjellim për lexuesin tonë disa prej tyre.

Në të gjitha shkrimet e tij vërejmë se ka folur me një respekt dhe me një shenjtëri të veçantë rreth dijetarëve të nderuar. Ai flet rreth tyre me superlativa të mëdha, të atilla që nuk i ka përmendur kurrë më parë për njerëz të tjerë. Ai i ka shprehur vazhdimisht konsideratat e tij të larta rreth dijetarëve. Respekti dhe vlerësimi i tij për ta ka qenë i pandërprerë. Një shembull i qartë, që flet dhe dëshmon këtë, është libri i tij “Dyzet Hadithet” - “El Erbaune Hadithen”, ku ai e cilëson Shejh El Kelinin si besnikërinë e Islamit dhe të myslimanëve. Herë të tjera e cilëson si “Argumenti i grupit dhe i besueshmi i tyre”. Herë të tjera e quan “Dijetarin më të madh të muhadithinëve dhe më të mirin e tyre”.

⁷ “Mizanul Hikmeh”, vëll. 3, f. 2088.

Një tjetër hoxhë të nderuar, (shejh) Nasirud Din Et Tusij, e konsideron si “Më i miri i dijetarëve të kohëve të vona dhe më i plotësuar i dijetarëve të kohëve të para”.

Një tjetër hoxhë, (shejh) El Behaijin, e cilëson si “Njohës i madh dhe shumë i nderuar”. Lidhur me El Alameh El Mexhlisij, thotë se ai ka qenë “Muhakik dhe Mudekik/redaktor, kontrollues dhe korrektues i madh”. Vlerësimi i tij i madh dhe respekti i tij i veçantë për dijetarët e nderuar është i qartë dhe lehtësisht i dukshëm në faqet e librit të tij.

Gjatë kohës së qeverisjes së tij, Imami i nderuar (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) është mbështetur shumë te dijetarët e nderuar. Ata kanë qenë krahu i tij i djathtë, dora e tij e fortë dhe syri i tij vigjilent te institucionet më të rëndësishme të shtetit, si dhe te ecuria e punëve të Islamit në vend. Në të gjitha institucionet e shtetit ai kishte të deleguarit e tij prej dijetarëve të nderuar. Ai nuk ka lejuar kurrë që institucionet përgjegjëse për mbarëvajtjen e punëve të shtetit dhe të qeverisë, të jenë të boshatisura prej përfaqësuesve të tij në secilin prej tyre, për të kontrolluar dhe për të mbikëqyrur në mënyrë rigoroze të gjithë aktivitetin e tyre.

Dijetarët kanë qenë pika e tij e dobët. Ashtu siç u vu në dukje edhe më sipër, ata kanë pasur një vend të veçantë te konsideratat e Imamit dhe një pozitë të lartësuar në

vlerësimin dhe në respektin e tij. Këtë dimension shumë të rëndësishëm e gjejmë të pranishëm te pjesa më e madhe e mendimeve dhe e deklaratave të tij. Nisur nga sa pamë më sipër, mund të themi se për Imamin e nderuar (Zoti qoftë i kënaqur me të!) dijetarët kishin këto pozita.

Le të sjellim për lexuesin disa prej atyre pozitave të përmendura prej tij:

1. Trashëgimtarët e Profetëve

Ata nuk kanë trashëguar prej tyre pasuritë dhe paratë, por kanë trashëguar dituritë. Kanë trashëguar prej tyre rolin qendror në këtë jetë.

Transmetime të shumta kanë hedhur dritë rreth kësaj të vërtete: Transmetohet prej të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*): “Dijetarët janë trashëgimtarët dhe pasuesit e dijetarëve. Ata janë të dashurit e banorëve të qiellit. Edhe balenat në det luten dhe i kërkojnë falje Allahut të Madhëruar për ta, kur ndahen nga kjo jetë, deri në Ditën e Gjykimit.”⁸

Në një tjetër transmetim prej të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të*

⁸ “Mizanul Hikmeh”, vëll. 3, f. 2067.

nderuar!) lexojmë: “Dijetarët janë ndriçuesit e kësaj bote. Ata janë trashëgimtarët e Pejgamberëve.”⁹

Duhet të jemi të vetëdijshëm se roli i Profetëve nuk është që ata të merren vetëm me një dimension të vetëm të jetës, siç është rasti i mjekëve që merren vetëm me shëndetin e njerëzve. Apo siç është rasti i inxhinierëve që merren me projektimin e ndërtesave dhe të objekteve të ndryshme. Apo siç mund të jetë profesioni i elektrikistit, që merret me çështjet që lidhen me profesionin e tij. Duke qenë se Profetët e Zotit nuk kanë qenë përfaqësues të një profesioni të caktuar, por kanë qenë të gjithanshëm, ashtu edhe trashëgimtarët e tyre, dijetarët, janë të gjithanshëm. Kështu, pra, t’i trajtosh dijetarët sikur janë përfaqësues të një profesioni të vetëm, është një qasje difektoze dhe shumë e gabuar. Kudo që të gjendet një rol për fenë islame, gjendet edhe roli i dijetarëve. Cili është ai aspekt, në të cilin nuk ka rol Islami?!

Imam Khomeini (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) thotë:

“Nuk ka dyshim se dijetarët, të cilët edukojnë brezat dhe njerëzimin, janë trashëgimtarët e Profetëve. Ata nuk janë gjë tjetër përveçse të dërguarit e dijetarëve.”¹⁰

⁹ “Mizanul Hikmeh”, vëll. 3, f. 2067.

2. Ata janë fytyra e Islamit dhe mënyra nëpërmjet të cilës paraqitet ai

Është e pamundur që dikush të njihet me Islamin e vërtetë, përveçse me ndërmjetësimin dhe me ndihmën e dijetarëve të nderuar myslimanë.

Vetëm nëpërmjet tyre mund të rreket Islami i vërtetë në dimensionet teorike dhe praktike. Ta kërkosim fenë të njerëz që nuk kanë lidhje me dijen dhe me fushën islame të dijes, është një prej formave më të komplikuar dhe më të dëmshme të iluzionit dhe të mirazhit.

Transmetohet prej Prijësit të Besimtarëve (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*): “Dijetarët janë treguesit e rrugës për të Allahu i Madhëruar.”¹¹

Lidhur me këto kuptime dhe me këto aspekte të rëndësishme, janë të shumta fjalët e Imam Khomeinit (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*). Ai thotë kështu: “Çallma në kokën e dijetarit është Islami vetë. Dijetarët janë të integruar në Islam.”¹²

Imami i nderuar (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) thotë, gjithashtu: “Ata dijetarë janë fytyra e Islamit, janë komentuesit dhe shpjeguesit e Kur’anit dhe shëmbëlltyra e

¹⁰ Prej fjalimit të shkëlqesisë së tij, të mbajtur, më 22.06.1979., në mesin e një grupi zonjash dhe anëtarësh të Gardës së Revolucionit Islamik. “Sahifet Nur”, vëll. 7, f. 181.

¹¹ “Mizanul Hikmeh”, vëll. 4, f. 2420.

¹² Shkëputur prej një fjalimi të shkëlqesisë së tij, mbajtur, më 23.05.1979., për një grup studentësh universitarë dhe profesorë të tyre. “Sahifet Nur”, vëll. 7, f. 229.

Profetit tonë të nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*).¹³

3. Qëllimet e Islamit janë pjesa kryesore e fjalëve të tyre

Nuk ka dyshim se e vërteta dhe fjalët e dijetarëve kanë peshën e tyre të veçantë, sa herë që i paraqiten popullit. Ato fjalë kanë një ndikim të veçantë në umetin islam (popullin islam). Ato janë fjalë që i ndezin pishtarët e udhëzimit për sytë e njerëzve. Ato fjalë kanë një ndikim të madh në popull dhe e ndihmojnë atë të përjetojë zgjim dhe të çlirohet prej iluzioneve dhe hamendësimeve boshe. Detyra e tyre madhore dhe e shenjtë është të marrin njerëzimin për dore dhe ta transferojnë atë për te Krijuesi i Gjithësisë dhe të udhëzimi i zbritur prej Tij. Me përpjekjet dhe me fjalët e tyre të mençura, ata mund ta shpien njerëzimin drejt bregut të paqes dhe të sigurisë, nëse ata i venë në jetë fjalët dhe udhëzimin e tyre.

Gjatë një fjalimi në mesin e një grupi dijetarësh, Imam Khomeini (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) thotë: “Të nderuar dijetarë! Ju duhet të jeni zëdhënësit e Islamit të vërtetë, të cilin njerëzit mbajnë shpresë. Kjo është detyra juaj më e madhe. Nëse dijet tuaja janë realiste, dini se kjo

¹³ Prej fjalimit të shkëlqesisë së tij, datë 23.12.1978., duke folur rreth faktorëve që ndikuan në triumfin e Revolucionit Islamik. “Sahifet Nur”, vëll. 4, f. 93.

është puna më e lartësuar dhe më e madhe që mund të bëni. Kjo është puna juaj më e madhe, sepse të gjitha qëllimet e Islamit realizohen nëpërmjet ndikimit që kanë fjalët tuaja dhe për këtë arsye, e them pa hezituat, se kjo është puna më e madhe që mund të bëni ju.”¹⁴

4. Ata janë rojtarët e Islamit

Kjo është njëra prej cilësive dhe njëri prej epiteteve më të bukura me të cilat Imami i nderuar (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) i ka cilësuar dijetarët. Duke qenë se Islami është drita e mrekullueshme e Zotit dhe se nuk ka dritë tjetër veç tij, mund të themi me bindje të plotë dhe me siguri se ai është njëkohësisht udhëzimi i vetëm dhe nuk ka udhëzim tjetër veç tij. Islami është Parajsa dhe gjithçka tjetër veç Islamit është ferri vetë. Ai është e vetmja mundësi për të fituar kënaqësinë e Allahut dhe për të nisur rrugëtimin për te Ai. Islami është feja që i jep jetës kuptim dhe e vesh atë me bukuri. Ai është qëllimi i vetë jetës. E ku mund të ketë nder më të madh për dijetarët, se sa të jenë rojtarët e kësaj feje?! Secili prej nesh është në gjendje tashmë të imagjinojë se sa i madh do të jetë rreziku, që do të hasim, nëse ne tregojmë se nuk kemi nevojë për ndihmesën dhe për angazhimin e këtyre dijetarëve në të gjithë sektorët e jetës publike. Të gjithë ne jemi të vetëdijshëm se sa e rrezikshme do të ishte, që të mos kemi

¹⁴ Shkëputur prej fjalimit të Imamit, të mbajtur, më 07.07.1979., në mesin e një grupi dijetarësh në Teheran. “Sahifet Nur”, vëll. 8, f. 67.

shërbimet e dijetarëve pranë nesh, në këtë botë të mbushur me kurthe, intriga e mashtrim.

Gjatë një fjalimi, të mbajtur për një grup dijetarësh, Imam Khomeini (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) thotë: “Hidhuni në sulm. Mos qëndroni kurrsesi pasivë. Mos prisni që gjërat të vijnë te ju, por shkoni ju në drejtim të tyre. Nuk është e pranueshme që ndonjë prej jush të thotë: “Unë jam dijetar i fik’hut (i jurisprudencës islame) dhe nuk më interesojnë çështjet e tjera që nuk kanë lidhje me fushën time. Jo, kjo nuk është e pranueshme. Duhet të jeni aktivë dhe duhet t’i “sulmoni” çështjet, të gjitha çështjet që lidhen me interesat e njerëzve dhe të ardhmen e tyre. Ju jeni rojet e Islamit dhe është detyra juaj, që ta merrni në mbrojtje atë.”¹⁵

Janë disa transmetime të Profetit të nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) që vijnë për të hedhur dritë rreth këtij roli shumë të rëndësishëm të dijetarëve. Në njërin prej këtyre transmetimeve ai thotë: “Shembulli i dijetarëve është si shembulli i yjeve lart në qiell. Ato na ndihmojnë të gjejmë rrugën në errësirën e tokës dhe të detit. Nëse yjet fiken, rrezikojmë ta humbim rrugën.”¹⁶

¹⁵ Shkëputur prej një fjalimi të mbajtur prej shkëlqesisë së tij, më 06.03.1979., në praninë e një grupi studentësh dhe dijetarësh në Kumm.

¹⁶ “Mizanul Hikmeh”, vëll. 4, f. 2840.

Ky rol i dijetarëve bëhet akoma më i domosdoshëm sot, në kohën e mungesës së Imamit të Kohës (*Lusim Allahun të shpejtojë ardhjen e tij!*). Në një transmetim që na vjen prej Imamit Udhëzues (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) thuhet: “Po të mos kishte prej atyre dijetarëve, të cilët do të qëndronin dhe do të rezistonin fort pas mungesës së Imam Mehdiut (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*); po të mos kishte prej atyre dijetarëve, që do t’u tregonin njerëzve rreth tij, prej atyre që do t’i ftonin njerëzit për te ai, prej atyre që u tregojnë njerëzve dhe u sqarojnë atyre argumentet e Allahut të Madhëruar; po të mos kishte prej atyre që i mbrojnë të varfrit dhe përpiqen t’i shpëtojnë ata prej rrjetave të Iblisit, prej atyre që përpiqen t’i shpëtojnë njerëzit prej kurthit të armiqve, nuk do të kishte mbetur njeri mbi tokë, përveçse do të kishte hequr dorë prej fesë së Allahut.”¹⁷

5. Prania e tyre është këshillë

Imami i nderuar (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) është i mendimit se dijetarët e nderuar, edhe nëse nuk marrin pjesë drejtpërsëdrejti në jetën kulturore dhe shoqërore të njerëzve, thjesht prania e tyre është një mundësi për t’i kujtuar atyre rrugën për te Allahu i Madhëruar dhe adhurimin e Tij. Lidhur me këtë aspekt, ai thotë: “Nëse në një shoqëri të caktuar apo në një qytet të caktuar gjenden

¹⁷ “Mizanul Hikmeh”, vëll. 3, f. 2087.

disa dijetarë të ndershëm, të cilët janë vërtet të mençur dhe merren me punët e fesë. Të jenë prej atyre të urtëve, të cilët venë në zbatim dijet e tyre, jam i bindur se nuk është e nevojshme që ata të bëjnë propagandë dhe të përhapin idetë e tyre. Vetë ekzistenca e tyre është thirrja dhe ftesa më e mirë. Të gjithë jemi të vetëdijshëm se gjenden disa persona që të frymëzojnë, të mësojnë dhe të këshillojnë vetëm me praninë e tyre. Janë të shumtë njerëzit që janë udhëzuar dhe janë ndier të frymëzuar, thjesht, prej pranisë së atyre çallmave në mesin e tyre. Sjellja e tyre ka mjaftuar që njerëzit të ndikohen dhe më pas të udhëzohen.”¹⁸

Të shohësh dijetarët e ndershëm dhe të ditur, është në vetvete këshillë e adhurim. Këtë aspekt e gjejmë të përmendur edhe te disa prej transmetimeve që na kanë ardhur prej të Dërguarit tw Allahut (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderur!*). Në njërin prej atyre transmetimeve ai thotë: “Shikimi në fytyrën e dijetarit është adhurim.”¹⁹

Në një tjetër transmetim, Profeti i nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) thotë: “Ata që presin dijetarët dhe u bëjnë respektin atyre, është sikur të më kenë pritur dhe të ma kenë bërë respektin mua. Ata që i vizitojnë dijetarët, kanë

¹⁸ “El Keuther”, vëll. 1, f. 203.

¹⁹ “Mizanul Hikmeh”, vëll. 3, f. 2070.

shpërblim dhe pozitë të njëjtë me atë që më ka vizituar mua. Ata që ulen pranë dijetarëve për të nxënë prej dijeve të tyre, është sikur të jenë ulur pranë meje dhe ata që ulen pranë meje, kanë pozita dhe shpërblim të njëjtë me ata që janë në rrugën e Zotit tim.”²⁰

Kështu, pra, të rrish pranë dijetarëve dhe t’i shoqërosh ata, është në vetvete një formë shumë e dashur dhe shumë e shpërblyer e adhurimit.

6. Ndhima e dijetarëve është më e vlefshme se gjaku i dëshmorëve

Të gjithë e dimë vlerën e madhe dhe pozitën e veçantë të gjakut të dëshmorëve te Allahu i Madhëruar. Ajetet kur’anore, që e mbështesin këtë mendim dhe këtë frymë, janë të prera dhe shumë të qarta. Allahu i Madhëruar, kur flet për dëshmorët në Kur’an, thotë:

"بل أحياء عند ربهم يرزقون"

“Ata janë të gjallë dhe ushqehen tek Zoti i tyre.”.

Po kaq të qarta janë edhe transmetimet e ndryshme, që flasin rreth (të pagabueshmëve/ma’asuminve). Dëshmori e ka shkurtuar rrugën për te Allahu i Madhëruar dhe për hatrin e madh të Tij ka vënë në dispozicion gjithçka ka pasur në pronësi, përfshi më të shtrenjtën pasuri, që është shpirti i tij. Gjurmët e gjakut të dëshmorëve dhe ndikimet që ai ka pasur në forcimin e

²⁰ “Mizanul Hikmeh”, vëll. 3, f. 2085.

Islamit dhe të ymetit dhe mbrojtjen e tij prej rreziqeve të ndryshme, janë të prekshme dhe të dukshme përgjatë historisë. Megjithatë, edhe pse kemi për detyrë të vlerësojmë dhe të nderojmë gjakun e martirëve tanë dhe ta pranojmë rolin e tyre të madh, e vërteta e madhe është se roli i dijetarëve, vlerat, rëndësia dhe pozita e tyre te Allahu i Madhëruar është akoma më e lartë se gjaku i tyre. E vërteta është se pesha e dijetarëve të nderuar, është më e madhe te Allahu i Madhëruar se gjaku i dëshmorëve. Le t'i hedhim një vështrim bashkërisht transmetimeve që kanë ardhur për këtë çështje:

Transmetohet prej të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*): “Në Ditën e Gjykimit, do të vihet në peshore kontributi (boja e penës së përdorur për të shkruar dijet) i dijetarëve dhe gjaku i martirëve. Pesha e kontributeve të dijetarëve do të peshojë më shumë se gjaku i dëshmorëve.”

Në një tjetër transmetim, të ardhur prej Profetit të nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) thuhet: “U peshua boja e përdorur për të shkruar dijen e dijetarëve dhe rezultoi më e rëndë se gjaku i derdhur prej dëshmorëve.”

Transmetohet prej Imam Sadikut (*Paqja e Zotit qoftë mbi të*): “Në Ditën e Gjykimit, kur Allahu i Madhëruar të mbledhë të gjithë njerëzit në Fushën e Mahsherit dhe të

sillet Peshorja, do të peshohet gjaku i martirëve dhe boja e penës së dijetarëve. Kjo e fundit do të rëndojë më shumë.”²¹

Imam Khomeini (*Zoti qoftë i kënaqur mbi të!*) hedh dritë rreth disa prej këtyre aspekteve dhe thotë: “Për qindra vite me radhë, dijetarët kanë qenë vendstrehimi më i paqtë dhe më i sigurt i të varfërve, i të vobektëve dhe i shtresave të të shtypurve të historisë. Të gjitha këto kategori njerëzish e kanë shuar etjen e tyre prej dijeve të këtyre kolosëve të mëdhenj të shkencës dhe të diturisë. Përveç dimensionit shkencor dhe ndriçues të përpjekjeve të tyre, i cili, në shumë aspekte, na rezultoi edhe më i vlefshëm se gjaku i martirëve, dijetarët e ndershëm, përgjatë historisë, kanë vuajtur dhe kanë duruar shumë. Janë përballur me llojet e ndryshme të dhimbjeve e të fatkeqësive, sa herë u është dashur të ngrihen në këmbë dhe të vihen në ballë të luftës për të mbrojtur gjithçka të shenjtë të fesë dhe të kombit. Ata dijetarë të nderuar janë burgosur, janë shtypur prej regjimeve barbare, janë akuzuar, kanë qenë preh e shpifjeve dhe e shtrëngimeve të llojeve të ndryshme. Shumë prej atyre dijetarëve të nderuar, përveçse kanë kontribuar me dijet e tyre të mëdha, janë martirizuar dhe kanë rënë dëshmorë.”²²

²¹ “Mizanul Hikmeh”, vëll. 3, f. 2067.

²² Thirrje e shkëlqesisë së tij, drejtuar dijetarëve dhe mendimtarëve të Iranit, më 22.02.1989.

Prej nga buron kjo pozitë e tyre?!

Pasi i lexuam dhe u njohëm nga afër me këto fjalë të mrekullueshme të Imam Khomeinit (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*), i cilit njihet për realizmin, racionalitetin dhe thellësinë e mendimeve të tij, është e drejta jonë të shtrojmë një pyetje: Prej nga erdhi kjo pozitë e dijetarëve?! Ku e ka zanafillën dhe burimin kjo pozitë?! Cila është arsyeja që dijetarët gjendeshin kaq të privilegjuar te mendimet e Imami (Zoti qoftë i kënaqur me të!)?! Cili është sekreti te përmendja e Imamëve të pagabueshëm (të pafajshëm) (*Paqja e Zotit mbi ta!*) dhe e rolit të dijetarëve në transmetimet e përmendura më sipër?!

Le t'i hedhim bashkërisht një vështrim rolit të tyre përgjatë historisë, si një përpjekje modeste për të kuptuar sekretin e pozitës dhe gradës së tyre të lartë.

KAPITULLI I DYTË

NDIHMJA E DIJETARËVE PËRGJATË HISTORISË

Imam Khomeni (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) ka thënë: “Nuk ka dyshim se hauzet e dijes dhe dijetarët e ndershëm e të devotshëm, kanë qenë përgjatë gjithë historisë kështjella të fortifikuara dhe strategjike të Islamit dhe të Shi’izmit. Ato kështjella kanë përballuar me sukses të gjitha përpjekjet për të shkatërruar fenë dhe për të përhapur devijim e shkatërrim.”

Lidhur me këtë aspekt, do të ndalemi për të hedhur dritë mbi dy dimensione të rëndësishme të dijetarëve.

1. Dimensioni shkencor
2. Dimensioni luftarak

Dimensioni shkencor në historinë e dijetarëve

Ky është njëri prej dimensioneve, të cilin Imami i nderur (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) e konsideron shumë të rëndësishëm dhe parësor. Në njërin prej fjalimeve të tij, citohet: “Dija është gjithçka në këtë jetë dhe ajo i përfshin të gjitha dimensionet më të rëndësishme të ekzistencës. Edhe shpata mund të përdoret, nëse lind nevoja për ta përhapur dijen. Asgjë nuk është më e rrezikshme se injoranca. Askush të mos hamendësojë dhe të mos ketë iluzion se, meqë i hymë politikës, të heqim dorë nga shkenca dhe nga dija. Është detyra më e rëndësishme e rinisë, që të zhvillohet mendërisht dhe të kultivojw sa të mundet dije.”²³

Bie në sy dhe është lehtësisht i prekshëm fakti se hauza e dijes dhe dijetarët e saj kanë mbajtur mbi supe dhe kanë luajtur tre role shumë të rëndësishme:

Roli i parë: Mbrojtja e trashëgimisë fetare prej humbjes dhe shkatërrimit

Dijetarët tanë të nderuar, kanë qenë ata që, me mund dhe me përpjekje, kanë mundur të ruajnë fenë, të

²³ Shkëputur prej një fjalimi të shkëlqesisë së tij, të mbajtur, më 06.03.1979., në prani të një grupi studentësh dhe dijetarësh.

përfaqësuar në ritet adhuruese, në historinë, në koncepte, në botëkuptime, në metodologji morale dhe shkencore, akaid (besim) etj.

Dikush mund të përfytyrojë se mbrojtja e kësaj trashëgimie të madhe nuk përfaqëson ndonjë mund të veçantë, a përpjekje të madhe. Në fakt, e vërteta është diametralisht e kundërt, veçanërisht kur kemi të bëjmë me dijetarët shi'itë, të cilët kanë qenë historikisht të sulmuar prej qeverive, prej shteteve të ndryshme dhe prej pushtetarëve zullumqarë.

Problematika nuk është e lidhur vetëm me mungesën e një shteti apo të një qeverie, e cila i mbështet përpjekjet e atyre dijetarëve. Problemi më i madh është se ato shtete e kanë luftuar historikisht Shi'izmin dhe shi'itët. Ato shtete kanë shkatërruar trashëgiminë e tyre, kanë djegur bibliotekat e tyre, kanë vrarë, kanë prerë e kanë masakruar dijetarët shi'itë. Pa mundin, sakrificat dhe vetëmohimin e atyre dijetarëve nuk do ishte e mundur që feja të mbërrinte deri në ditët tona. Sakrificat, përpjekjet dhe lufta e tyre e madhe për ta mbrojtur fenë, janë fuqimisht të pranishme gjatë gjithë historisë (*Kënaqësia e Allahut qoftë mbi të gjithë ata!*).

Një shembull i qartë dhe i prekshëm, lidhur me këtë, është ndodhia e Muhamed bin Umejrit, i cili ka qenë prej shokëve dhe miqve të dy imamëve, Imam Rizait dhe

Imam Kazimit (*Paqja e Allahut qoftë mbi ata të dy!*). Historia na tregon se ai është përballur me shumë vuajtje, padrejtësi, burg dhe persekutim të ushtruar prej Ma'munit, i cili ka qenë njëri prej kalifëve të Dinastisë Abasite. Ai është burgosur katër vite dhe, gjatë kësaj kohe, motra e tij ia ka groposur librat, në përpjekje për t'i mbrojtur ato prej zhdukjes dhe shkatërrimit, sepse ushtarët e Ma'munit ishin ngado. Por, pas katër viteve nën dhë librat u shkatërruan. Deshi Allahu i Madhëruar, që ai i kishte mësuar hadithet dhe, pasi doli nga burgu, u tregonte njerëzve gjithçka që e kishte të ruajtur në mendjen e tij.

Kështu, pra, mbrojtja e kësaj trashëgimie të jashtëzakonshme është një detyrë e madhe dhe aspak e lehtë, që qëndron mbi supet e dijetarëve.

Dijetarët tanë të nderuar e kanë përballuar me sukses këtë mision të lartë dhe të shenjtë përgjatë historisë. Shumë prej tyre janë martirizuar gjatë rrugëtimit të rrezikshëm dhe të vështirë, ashtu siç jemi njoftuar prej burimeve të ndryshme të historisë.

Imam Khomeini (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*), rreth këtyre të vërtetave, gjatë fjalimeve të ndryshme, të mbajtura, ka hedhur dritë shpesh dhe ka thënë: "Askush të mos mendojë se ka qenë detyrë e lehtë për dijetarët tanë të nderuar, që të marrin në mbrojtje shkencat kur'anore, hadithin, transmetimet e shumta të Ehli Bejtit. Nuk ka qenë

asapak një mision i lehtë, që t'i mbledhin ato dije, t'i klasifikojnë, t'i grupojnë ato në kapituj, në kushtet e përndjekjes dhe të fshehtësisë. Kjo ka qenë një detyrë jashtëzakonisht e vështirë në kushtet e përndjekjes së pushtetarëve, të zullumqarëve dhe të ushtarëve të Ma'amunit, të cilët kanë pasur për qëllim shuarjen e plotë të kësaj trashëgimie dhe zhdukjen një herë e përgjithmonë të gjurmëve të mesazhit të Allahut. Falënderimet më të përzemërta i takojnë Allahut të Madhëruar. Ne shohim dhe prekim sot rezultatet dhe frytet e përpjekjeve të tyre të mëdha. Shembull konkret, lidhur me këtë, janë "Katër Librat" dhe shumë libra të tjerë, të shkruar në fusha të ndryshme prej dijetarëve të vonshëm dhe prej atyre më të hershëm. Ata kanë shkruar rreth jurisprudencës islame, filozofisë, matematikës, astronomisë, rreth shkencave të hadithit, të parimeve (usulit), të transmetuesve të hadithit, rreth gramatikës, komentimit të Kur'anit, rreth letërsisë, rreth logjikës, si dhe rreth të gjitha degëve dhe nëndegëve të tjera të dijes dhe të shkencës.

Nëse të gjitha këto përpjekje dhe sakrifica nuk i quajmë (xhihad) përpjekje e luftë, atëherë çfarë mund të quajmë tjetër të tillë?"

Në një tjetër komunikim të tij, Imami i nderuar thotë:

“Nuk ka dyshim se hauzet e dijes janë ato që e kanë mbrojtur Islamin deri tani. Po të mos ekzistonin këta dijetarë, Islami nuk do të përmendej më prej askujt. Ata që i dhanë Islamit jetë dhe frymë në ditët e tij më të errëta, janë dijetarët.”²⁴

Roli i dytë: Shpjegimi i saktë i Islamit

Roli i dijetarëve të nderuar të hauzes, nuk ishte specifikisht i lidhur me përcjelljen e transmetimeve dhe të ngjarjeve historike. Ata kanë punuar me përkushtim të madh për të shpjeguar për njerëzit kuptimet e këtyre transmetimeve dhe të terminologjive komplekse të gjendura në to. Ata janë kujdesur për të afruar kuptimet dhe shpjegimet e vërteta të atyre transmetimeve. Për hir të së vërtetës, kjo është një detyrë e vështirë që nuk duhet parë me nënvlerësim.

Allahu i Madhëruar i ka krijuar gjuhët e ndryshme të popujve, në mënyrë të atillë që mbartin në vetvete dhe reflektojnë kuptime nga më të larmishmet. Ky elasticitet gjuhësor, që vjen shpesh si rezultat i madhështisë së një gjuhe të caktuar, ua mundëson disa njerëzve keqdashës dhe qëllimligj, që ta keqpërdorin gjuhën dhe ta venë atë në funksion të qëllimeve të tyre negative. Për shkak të këtyre hapësirave në interpretim, këta njerëz qëllimligj i japin

²⁴ Shkëputur prej fjalimit të shkëlqesisë së tij, më 04.03.1979., ditën e kthimit të tij prej qytetit të Kummit.

Zbulesës Hyjnore kuptime të ndryshme nga ato që Allahu i Madhëruar ka dashur realisht të përcjellë. Për të qartësuar këtë çështje, na mjafton të sjellim si shembull abdesin dhe mënyrën se si ai është sqaruar në Kur'anin Famëlartë.

Allahu i Madhëruar thotë:

"اغسلوا وجوهكم وأيديكم إلى المرافق وامسحوا برؤوسكم وأرجلكم إلى الكعبين"

"Lani duart tuaja deri te bërrylat dhe më pas (jepini mes'h/fshijini) kokat tuaja dhe këmbët deri në kyçe." Edhe pse Kur'ani Famëlartë e ka shpjeguar qartë çështjen e abdesit, duke urdhëruar për fshirje (mes'h) për kokën edhe këmbët, shohim dhe konstatojmë me keqardhje se një pjesë e myslimanëve e lidhin fjalën (këmbët tuaja) të përmendur në ajet me (duart në fillim të ajetit), çka do të thotë se kanë dhënë fetva (urdhër fetar) për larjen e tyre në vend të (mes'hit/fshirjes)

Myslimanët nuk kanë asnjë kundërshti lidhur me origjinën apo me tekstin e ajetit, por janë kundërshtuar mes veti rreth komentimit të tij. E vërteta është se njëri prej komentimeve dhe shpjegimeve i jep ajetit dhe rrjedhës logjike të kuptimeve të tij, rrjedhë krejt të ndryshme. Nisur nga ky fakt, mund të themi se mbrojtja e fesë nuk mund të realizohet përmes mbrojtjes dhe ruajtjes së fjalëve apo të teksteve, por bashkë me to duhet të mbrohen dhe të ruhen edhe interpretimet e atyre teksteve.

Kjo është një tjetër lloj lufte dhe përpjekje, e realizuar me sukses prej dijetarëve. Kështu, këta dijetarë të ndershëm kanë qenë në vazhdimësi të sigurt për mbrojtjen e kuptimeve të fesë prej keqinterpretimit dhe devijimit. Përveç këtij aspekti, ata kanë ushtruar autoritetin e tyre teologjik për t'i vënë kuptimet e atyre transmetimeve në funksion të realiteteve të reja që lindin herë pas here.

Lidhur me rëndësinë e madhe të këtij roli të rëndësishëm të dijetarëve, Imam Khomeini (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) ka thënë: “Po të mos ishte prania e dijetarëve tanë të ndershëm dhe krenarë, askush nuk do të ishte në gjendje të tregojë me kompetencë se si sot mund të shpjegoheshin tekstet e shenjta islame dhe trashëgimia shkencore e familjes (dinastisë) Profetike.

Dijetarët tanë të nderuar e kanë kryer detyrën e tyre me ndershmërinë dhe me përkushtimin më të madh, përgjatë historisë. Lidhur me këtë aspekt, Imami i nderuar (*Kënaqësia e Zotit qoftë mbi të!*) thotë: “Përsa u përket shërbimeve të ndryshme dhe të larmishme që i kanë ofruar dijetarët e hauzes, është një fushë për të cilën mund të flitet gjatë dhe nuk është e mundur të përfshihen në këtë trajtesë të përmbledhur. Falënderimi i takon Allahut të Madhëruar, që hauzet janë të armatosura me një sasi të madhe rrugësh, mënyrash e burimesh, për të realizuar me sukses kërkimet e tyre shkencore. Ata kanë qasje shumë të zhvilluara dhe moderne, lidhur me këtë aspekt. E vërteta

është se në përfytyrimin tim nuk gjendet një mënyrë më e përshtatshme dhe më e thellë për të studiuar imtësisht të gjitha dimensionet e shkencave fetare, sesa mënyra e të parëve tanë të ndershëm (selefët). Një histori që i kaluar njëmijë vite tashmë, e mbushur me ndjekje të imtësishme dhe hulumtime shkencore brez pas brezi e të gjithë dijetarëve tanë të mëdhenj, është argumenti më i qartë dhe më i madh se për këtë fe të pastër të Zotit ekziston një përkujdesje e veçantë. Dijetarët e mëdhenj të Islamit kanë qenë historikisht vendpreshja e shtresave të persekutuarra të popullsisë dhe e të shtypurve të tyre. Përgjatë shekujve të gjatë të historisë, të gjithë të shtypurit e botës kanë ujitur dhimbjet e tyre me lëngun e shtrydhur të dijeve të tyre dhe të mirësisë.”

Në një tjetër deklaratë, Imami i nderuar (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) thotë: “Po të mos kishin qenë këta dijetarë të mëdhenj dhe përpjekjet e tyre prej njëmijë vitesh e deri tani, nuk do të dinim asgjë rreth kësaj feje të shenjtë. Ata janë dijetarët që kanë njohur Islamit dhe kanë depërtuar thellë dijeve të tij. Janë ata njerëzit e mëdhenj, të cilët kanë vuajtur shumë, vetëm që të sjellin këtë fe për ne.”²⁵

²⁵ Shkëputur prej fjalimit të shkëlqesisë së tij, më 08.09.1981., në mesin e një grupi imamëve të xhamive. “Sahifet Nur”, vëll. 15, f. 150.

Roli i tretë: Shpjegimi i fesë dhe përhapja e saj në mesin e njerëzve

Përveç shpjegimit të fesë dhe mbrojtjes së saj prej armiqve, dijetarët morën mbi supet e tyre një rol tjetër. Përhapjen e saj në mesin e njerëzve. Ata kanë shpenzuar në këtë rrugë gjithçka të shtrenjtë që kanë, madje disa prej tyre kanë dhënë edhe jetën. Një shembull i madh për këtë ka qenë njëri prej dijetarëve të mëdhenj dhe të njohur, shkruesi i shumë librave të rëndësishëm dhe me vlerë, Muhamed bin Meki el Amilij, i njohur gjithashtu si martiri i parë. Ai u mbajt i burgosur për një vit rresht në kalanë e Damaskut, përpara se t'i pritej koka. Mëkati i tij i vetëm ishte se i përkiste një shkolle islame të ndryshme nga ai i qeveritarëve të kohës.

Një tjetër shembull, prej dijetarëve që kanë pasur të njëjtin përfundim, është Zejnud Din bin Ali el Amilij el Xhebaij, një dijetar shumë i njohur dhe autor i disa librave me shumë vlerë. Ai njihet si martiri i dytë dhe është vrarë për të njëjtat arsye.

Këta janë njerëzit e ndershëm dhe dijetarët tanë të mëdhenj, që nuk kursyen as gjakun e tyre në shërbim të fesë dhe në shërbim të përhapjes së Ligjit të Allahut dhe të fesë së Tij.

Lidhur me këtë të vërtetë të madhe, Imam Khomeini (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) thotë: “Dijetarët tanë të nderuar kanë shpenzuar jetën e tyre të shenjtë, duke studiuar dhe duke hulumtuar. Kanë shpenzuar ditët e jetëve të tyre për t’u sqaruar myslimanëve çështjet e hallallit dhe të haramit në Islam dhe nuk kanë lejuar askënd që të ndërhyjë dhe të ndikojë tek ato çështje.”

Ai thotë gjithashtu: “Nuk ka dyshim se dijetarët tanë të ndershëm, të nderuar dhe shumë të respektuar, luftëtarët dhe sakrifikuesit e mëdhenj, i kanë shkrirë të gjitha energjitë e tyre në funksion të mbrojtjes së Islamit dhe të përhapjes së tij. Këtë detyrë të shenjtë dhe fisnike, e kanë ushtruar në kohërat më të rrezikshme dhe më të vështira të historisë. Me zemrat e tyre të mbushura me shpresë dhe me shpirtrat e tyre të mbushura me besim e dashuri për çështjen e tyre, ata mundën ta përhapin Islamin, ta mbrojnë atë dhe t’ua shpjegojnë myslimanëve çështjet e tij brez pas brezi, përgjatë historisë.”

Dimensioni luftarak i përpjekjeve në historinë e dijetarëve

Dijetarët tanë të nderuar nuk janë mjaftuar vetëm me mbajtjen mbi supet e tyre të përgjegjësisë së transmetimit të dijes. Krahës kësaj përgjegjësie ata kanë mbajtur mbi supet e tyre dhe janë përballur gjithashtu me tiranë, diktatorë e zullumqarë. Ata kanë bërë të mundurën dhe të pamundurën për mbrojtjen e shoqërive islame prej kurtheve dhe luftimit të armiqve të Islamit.

Lidhur me këtë rol të rëndësishëm të tyre, Imam Khomeini (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) deklaroi: “Krahës luftës dhe përpjekjeve të tyre madhore për mbrojtjen e fesë dhe përhapjen e saj, që konsiderohet në shumë dimensione edhe më i vlefshëm se gjaku i martirëve, dijetarët tanë të nderuar kanë bërë luftë dhe përpjekje të mëdha, për mbrojtjen e fesë, të kombit dhe të gjithçkaje të shenjtë. Ata janë përballur me llojet e ndryshme të përndjekjes, të persekutimit, të zullumit, të internimit, të burgosjes dhe të padrejtësisë. Në fushëbetet e shenjta, shumë prej tyre janë martirizuar për të mbrojtur gjithçka të shenjtë, për ta mbrojtur këtë fe. Duhet të jeni të gjithë të mirinformuar se numri i dijetarëve, që janë martirizuar për hir të kësaj feje të shenjtë, nuk është vetëm ai që njihet dhe që është

regjistruar prej përballjeve dhe luftërave të Republikës Islamike të Iranit. Është një armatë tjetër martirësh prej dijetarëve të panjohur (të hauzes), të cilët janë zhdukur dhe janë eliminuar në kushte dhe në rrethana krejtësisht misterioze. Numrin e tyre të vërtetë e dinë vetëm agjentët, spiunët dhe shërbëtorët e dukshëm dhe të padukshëm të armiqve të vendit tonë.”²⁶

Një shembull i qartë, lidhur me këtë aspekt është Es Sejid Abdolhosein Sherefodin, dijetari i madh që ka luftuar kundër pushtuesve francezë, në kohën kur ata pushtuan këto vende. Një shembull tjetër ka qenë El Alamah Medresij, i cili u përball me qeveritë zullumqare në Iran, derisa u martirizua. Në Irak, gjithashtu, kemi shembullin e Shirazit të ndier, ky burrë i madh që organizoi rebelimin dhe Revolucionin e Timbakut. Kështu, pra, dijetarët tanë të nderuar kanë qenë të pranishëm me të gjithë fuqinë e tyre në të gjitha fushëbetejat e rëndësishme të jetës dhe të Islamit. Kjo kohë zgjati deri në kohën kur u ngrit Imam Khomeini (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*).

Imami i nderuar thotë: “Cili është ai revolucion popullor islam, në krye të të cilit mungojnë dijetarët tanë të drejtë dhe të ndershëm të hauzes së shenjtë?! Cilat janë ato revolucione islame mbarëpopullore, rrugët e të cilave nuk

²⁶ Shkëputur prej fjalimit dhe thirrjes së Imamit të nderuar (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*), mbajtur, më 22.02.1989.

janë hapur me trupa dhe me gjak dëshmorësh të dijetarëve tanë të dashur dhe të nderuar?!”

Imami i nderuar thotë, gjithashtu: “Të gjithë ata që e njohin mirë historinë, janë të vetëdijshëm se ata që janë ngritur kundër tiranive dhe diktaturave janë dijetarët.”

Këta dijetarë nuk janë një përjashtim

Ndonjë prej lexuesve tanë të nderuar, mund të mendojë se dijetarët e përmendur më sipër janë thjesht një përjashtim. Pra, dikush mund të aludojë, me ose pa dashje, se nuk ka qenë kjo situata dhe gjendja e përgjithshme në kampin e dijetarëve tanë të nderuar në hauzen e shenjtë. Disa njerëz apo grupime të caktuara njerëzish përpiqen të hedhin akuza dhe të fabrikojnë alibi për një pjesë të këtyre personaliteteve, me qëllim prishjen dhe dëmtimin e imazhit të tyre. Për të hequr çdo hije dyshimi dhe për të larguar një herë e përgjithmonë çdo iluzion e akuzë, Imami i nderuar (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) e ka cilësuar mjedisin e përgjithshëm të hauzës dhe duke folur rreth saj ka deklaruar: “Nuk ka dyshim se deri në ditët e sotme, janë hauzet e dijes ato që e kanë marrë në mbrojtje Islamin.”²⁷

Ai thotë, gjithashtu: “Nuk ka dyshim se hauzet e dijeve dhe dijetarët tanë të devotshëm, përgjatë historisë islame dhe të Shi’izmit, kanë qenë, kështjella dhe kalaja më e rëndësishme për ta mbrojtur Islamin prej sulmeve të armiqve dhe prej deviacioneve të ndryshme.”

²⁷ Shkëputur prej fjalimit të shkëlqesisë së tij, më 29.02.1979., mbajtur në ditën e kthimit të tij prej qytetit të Kummit.

Ky rol i rëndësishëm i dijetarëve nuk ka qenë i fshehtë për diktatorët dhe për pushtetarët tiranë. Për këtë arsye dhe jo vetëm, këta dijetarë të mëdhenj dhe të ndershëm kanë qenë shënjestra kryesore e pushtuesve kolonizatorë. Roli dhe ndikimi i tyre i madh ka qenë shënjestra kryesore e armiqve të Islamit. Këta armiq dhe pushtues, nuk kanë qenë të vetmit që i kanë sulmuar e i kanë përndjekur këta dijetarë, por janë shumë faktorë të tjerë të niveleve dhe të natyrave të ndryshme. Le të hedhim një vështrim të përgjithshëm rreth natyrës së persekutimit të dijetarëve.

KAPITULLI I TRETË

SHËNJESTRIMI I DIJETARËVE

Imami Khomeini (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) thotë:

“Është detyrë e imja që t’i vë në dijeni të gjitha hauzet e dijes, duke filluar me hauzen e nderuar të Kunit, te ajo e Mesh’hedit dhe të gjitha hauzet e tjera, të cilat i dini dhe i njihni dhe t’ju them se jeni sot në krye të listës së armiqve tuaj. Nuk ka dyshim se jeni shënjestra e parë dhe më e madhe e kurtheve të liga të shteteve të mëdha.”²⁸

Janë disa faktorë të ndryshëm ato që i kanë vendosur dijetarët në shënjestrën e armiqve të Islamit, nga të katra anët e horizontit. Natyra e shënjestrimit të tyre, nuk është e lidhur vetëm me plumba, që janë vënë në

²⁸ Shkëputur prej fjalimit të shkëlqesisë së tij, më 07.07.1979., në prani të një grupi dijetarësh të Teheranit. “Sahifet Nur”, vëll. 8, f. 67.

kërkim të trupave të dijetarëve, por me përpjekje djallëzore për të prishur imazhin tuaj.

Le të sjellim për lexuesin, disa raste të shënjestrimit të dijetarëve tanë të nderuar:

Shënjestrimi i tyre prej pushtuesve

Një rol dhe një ndikim kaq i madh i dijetarëve tanë të ndershëm dhe mendjendritur ka qenë dhe mbetet një halë në syrin e pushtuesve dhe të grabitqarëve të huaj. Nuk do të ishte normale që ata të qëndrojnë të paimterësuar, lidhur me këtë ndikim të madh. Këta dijetarë të ndershëm kanë qenë pengesa e tyre më e madhe në realizimin e epsheve dhe të synimeve të tyre, për përvetësimin e pasurive të vendeve tona dhe të gjithë myslimanëve. Kjo është arsyeja kryesore përse kalaja e tyre do të jetë vazhdimisht në qendër të sulmeve dhe të vëmendjes së tyre.

Lidhur me këtë aspekt, Imami Khomeini (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) ka thënë: “Që sot e tutje, e gjithë bota islame dhe të gjithë dijetarët e ndershëm dhe të ditur të saj, do të përballen me shënjestrimin e armiqve të Islamit dhe të vendeve tona. Ata do të synojnë vazhdimisht të hedhin baltë, të sajojnë akuza dhe të shpifin kundër dijetarëve të Islamit, që përfaqësojnë ajkën e shoqërisë. Dijetarët tanë të ndershëm dhe të pastër nuk e kanë ulur kurrë hundën e tyre dhe nuk janë nënshtruar ndaj kapitalistëve të mëdhenj. Ata nuk i janë nënshtruar kurrë atyre që paranë e kanë zot dhe gjatë gjithë jetës së tyre e kanë ruajtur nderin e tyre dhe pastërtinë.”

Imami i nderuar thotë, gjithashtu: “Është detyrë e imja që t’i vë në dijeni të gjitha hauzet e dijes, duke filluar me hauzen e nderuar të Kunit, te ajo e Mesh’hedid dhe të gjitha hauzet e tjera, të cilat i dini dhe i njihni dhe t’ju them se jeni sot në krye të listës së armiqve tuaj. Nuk ka dyshim se jeni shënjestra e parë dhe më e madhe e kurtheve të liga të shteteve të mëdha.”²⁹

Një prej problemeve më të mëdha, me të cilat janë përballur armiqtë e Islamit është se dijetarët e nderuar nuk kanë pasur kurrfarë vartësie financiare prej askujt. Për këtë arsye, nuk ka qenë e mundur që të ushtrohet mbi ta presion dhe trysni e lidhur me aspektin ekonomik e financiar. Ata nuk kanë qenë kurrë pjesë e klanit të një udhëheqësi të caktuar politik, në mënyrë që të ushtrojnë trysninë e tyre në mënyrë indirekte, pra, nëpërmjet liderit apo personalitetit ekonomik. Ata nuk kanë pasur kurrfarë interesi për të mirat materiale të kësaj bote, në mënyrë që presioni të ushtrohej nëpërmjet kësaj pike të dobët që e kanë pjesa më e madhe e njerëzve. Kjo është arsyeja kryesore, përse ata kanë pasur një vend të veçantë të zemrat e njerëzve dhe emër shumë të pastër në popullatë.

Lidhur me këtë aspekt, Imami i nderuar (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) ka thënë: “Reputacioni i tyre, në mesin e

²⁹ Shkëputur prej fjalimit të shkëlqesisë së tij, më 07.07.1979., në prani të një grupi dijetarësh të Teheranit. “Sahifet Nur”, vëll, 8, f, 67.

njerëzve, nuk u vendos me dhunën e shpatës, as me dhunën e parasë së pisët, që e kanë adhuruesit e parasë. Ky reputacion është vendosur nëpërmjet artit të modestisë, të përkushtimit dhe të qenit të tyre vazhdimisht pranë nevojave dhe halleve të njerëzve të thjeshtë.”³⁰

Për këtë arsye, pasi pushtuesit e panë se joshja apo presioni ndaj tyre nuk mund të funksiononte, cilado qoftë forma dhe mënyra e tyre, ata kishin vetëm një rrugë, të ndiznin motorët e propagandës dhe të shpifjeve të tyre kundër dijetarëve dhe kundër hauzeve të dijes, në mënyrë që njerëzit të largohen prej tyre, si e vetmja mënyrë për të goditur ndikimin e tyre të shtresat e ndryshme të popullsisë.

Imami i nderuar thotë: “Cila është arsyeja, përse e paraqesin Islamin në mënyrë të deformuar?! Cilat janë arsyet që i shtyjnë ata të hedhin baltë mbi dijetarët e Islamit dhe mbi çallmat që ata mbajnë mbi krye?! Kjo ndodh për një arsye shumë të thjeshtë. Armiku më i madh i tyre është Islami dhe se ata që e synojnë, e dëshirojnë dhe e shpresojnë implementimin e tij si formë e qeverisjes së shtetit, janë dijetarët që mbajnë ato çallma mbi krye. Ata nuk mund të pranojnë kurrësi që kjo të realizohet. Për këtë arsye, e shfaqin Islamin në mënyrë të deformuar dhe

³⁰ Shkëputur prej thirrjes së Imami të nderuar (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*), mbajtur, më 22.02.1989., drejtuar një grupi dijetarësh myslimanë të vendit.

hedhin baltë mbi çallmat dhe mbi dijetarët tanë të nderuar. Kjo është e vetmja mënyrë dhe e vetmja mundësi që ata të realizojnë planet e tyre dhe të mos hasin pengesa prej askujt.”³¹

³¹ Shkëputur prej fjalimit të shkëlqesisë së tij, mbajtur, më 11.10.1978., duke folur rreth ndikimit të Shaut të Iranit në realizimin e planeve të imperializmit. “Sahifet Nur”, vëll. 2, f. 139.

Infiltrimi i agjentëve në mesin e dijetarëve

Imam Khomeini (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) thotë: “Njëra prej strategjive dhe formave që armiqtë e Islamit kanë përdorur për të prishur imazhin e Islamit dhe të hauzeve të dijes, është infiltrimi në ato hauze i agjentëve dhe i njerëzve të shthurur. Këta njerëz të liq përbënin një rrezik afatshkurtër dhe të shpejtë për reputacionin e Islamit dhe të atyre hauzeve, pasi metodat e tyre djallëzore dhe morali i tyre i shthurur, ndikonte në mënyrë të menjëhershme te mendjet e njerëzve. Kjo, përsa i përket ndikimit të tyre në rrafshin afatshkurtër. Rreziku më i madh është i lidhur me ndikimin e tyre në rrafshin afatgjatë. Loja e tyre e ulët dhe e fëlliqur, maskimi dhe hipokrizia mund të hapë përpara tyre rrugën për përfundimin e stadeve të nxënies së dijes në hauzet e nderuara të dijes dhe më pas mbërritja e tyre në postet më të larta dhe më strategjike të drejtimit të shtetit.”³²

Në disa raste ndodh që personi të mos jetë i infiltruar prej faktorëve të jashtëm dhe prej armiqve të vendit, por atij i mungojnë elementet bazë të formimit shkencor, moral, psikologjik, fetar për të mbajtur mbi supet e tij peshat e rënda të drejtimit të shtetit apo të pozicioneve

³² Shkëputur prej amanetit të tij politik hyjnor, datë 04.06.1989.

të rëndësishme dhe strategjike të tij. Për këtë arsye, vëmë re shpesh se personazhe të tilla rrëzohen dhe gjunjëzohen pas sprovës dhe pas përballjes më të parë me vështirësitë.

Lidhur me këtë kategori njerëzish apo dijetarësh, Imami i nderuar (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) ka urdhëruar: “Një ditë prej ditëve na u bashkua në shtëpinë time i ndjeri (rahmetilu) Imam Beruxherdi, bashkë me të ndjerin (rahmetilun) Es Sejid El Huxh’xhet, bashkë me të ndjerin (rahmetliun) Es Sejid Es Sadr, bashkë me të ndjerin (rahmetilun) Es Sejid El Khunsarij (*Zoti qoftë i kënaqur me të gjithë ata!*). U mblodhëm për të diskutuar rreth një çështjeje politike, të një rëndësie të veçantë. U thashë atyre: “Detyra juaj kryesore është të identifikoni dhe të njihni nga afër të gjithë ata që e mbajnë veten për shenjtorë. Shembulli i tyre është si shembulli i armiqve tuaj, kur vijnë dhe ju prangosin duart (ua lidhin duart) dhe nuk ju lejojnë të veproni. Dijeni se këta njerëz që e shesin veten për të shenjtë, nuk janë aspak të tillë. Atyre nuk u intereson aspak e mira dhe e keqja. Ata kanë vetëm një funksion. Të mbajnë duart tuaja të lidhura. Të mos ju lejojnë të veproni.”

Ndodh që kjo kategori njerëzish të ketë një profil të komplikuar të të menduarit dhe të karakterizohen prej një ngurtësie jo lehtësisht të kuptueshme në kuptimin rrënjësor të çështjeve të rëndësishme të Islamit. Këta njerëz mendojnë se Islami është i lidhur vetëm me namaz, me

agjërëm dhe me adhurime të tjera individuale, duke mos e vënë re për asnjë moment se Islami është diçka shumë më e madhe dhe më e gjerë se aq. Ai është mënyrë jetese dhe formë qeverisjeje dhe ky është dimension i më i rëndësishëm, të cilin nuk duhet ta heqë prej mendjes askush. Ndodh shpesh, që njerëz të caktuar nga kjo kategori njerëzish, të dalin dhe të artikulojnë ftesë për të ndarë fenë nga politika dhe në këtë mënyrë i hapin rrugë, në mënyrë indirekte, të gjithë zullumqarëve dhe grabitqarëve të realizojnë synimet e tyre të zeza.

Lidhur me këtë aspekt, Imami i nderuar (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) thotë: “Nëse vijnë dhe ju thonë: “Ejani të bashkëjetojmë në paqe, ta duam njëri-tjetrin dhe të mos lejojmë që të jetojmë në sundimin e çallmave, duhet ta kini të qartë se këto janë thirrjet dhe ftesat e fabrikua në Izrael. Mos i lejoni ata që t’i paralizojnë shoqëritë myslimane me helmet e tyre. Ata përpiqen gjithmonë që t’i veshin opozitës një lloj shenjtërie të rreme.”³³

³³ Shkëputur prej librit “El Hukumu el islamijetu”

Dashuria për të mirat materiale të kësaj bote

Shumë njerëz, me ose pa vetëdije, harrojnë rolin e tyre kryesor përse i ka krijuar Allahu i Madhëruar dhe përse kanë ardhur në këtë botë. Me kalimin e kohës, zemrat e njerëzve lidhen fort pas bukurive dhe joshjeve të ndryshme të kësaj bote të rreme. Këta njerëz të dobët dhe të shthurur, zemrat e të cilëve janë ngushtësisht të lidhura me bukuritë dhe të mirat materiale të kësaj bote, janë të mendimit se pengesa më e madhe, që i ndalon ata të realizojnë synimet dhe përfitimet e tyre, është Islami dhe dijetarët e Islamit. Ata janë vazhdimisht të shqetësuar prej vizionit të qartë të atyre dijetarëve të mëdhenj dhe të ndershëm dhe janë të bindur se ata nuk i bëjnë llogari askujt tjetër përveçse Allahut të Madhëruar. Për këtë arsye dhe për arsye të tjera, të lidhura me qëllimet e tyre të liga, këta njerëz venë në dispozicion të gjitha mundësitë që kanë për të shkatërruar Islamin dhe për të rrënuar reputacionin dhe ndikimin e këtyre dijetarëve të nderuar të mendjet, shpirtit dhe të zemrat e njerëzve.

Lidhur me këtë aspekt, Imami i nderuar (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) herë pas here, hedh dritë, në mënyrë të tërthortë, rreth kësaj dukurie dhe thotë: “A mos vallë ekziston ndonjë dispozitë islame, a urdhër fetar që kërkon prej myslimanit të hedhë akuza, të shpifë për pjesën tjetër

të myslimanëve, qoftë ky individ apo grup individësh?! A mos vallë, ekziston ndonjë dispozitë islame që kërkon prej myslimanëve të akuzojnë, të shpifin dhe të hedhin baltë mbi figurat dhe dijetarët e nderuar të Islamit?! A mos vallë, ekziston ndonjë dispozitë që kërkon prej myslimanit të ofendojë kolegët e tij?! A mos vallë, është Islami ai që i jep këto udhëzime dhe ne nuk jemi të informuar?! Jo, të dashur vëllezër, nuk janë dispozita, as kërkesa të Islamit këto. Këto janë sjellje që burojnë prej lidhjes së zemrës së myslimanit me këtë botë të rreme, me këtë botë mashtruese, me këtë botë kalimtare. Nuk ka lidhje Islami, të dashurit e mi. Kjo sjellje është cytje prej cytjeve të shejtanit të mallkuar. Është energji e zezë që buron prej nevojave dhe kërkesave të errëta të egos.

Thashethemexhinjtë

Është një kategori njerëzish dhe një shtresë jo e vogël e popullsisë, që është tmerrësisht e pasionuar dhe e lidhur shpirtërisht me llojet dhe format e ndryshme të thashethemeve, përgojimeve dhe të fjalëve të ulëta, të ndyra dhe të pavlera. Mënyra se si ata reagojnë dhe ndërveprojnë me këtë kategori lajmesh e habresh të rrugicave është tmerrësisht negative. Detyra e këtyre njerëzve është që ta marrin lajmin, ta përpunojnë, ta stërhollojnë, ta zbukurojnë, ta trashin, ta zmadhojnë, ta përkeqësojnë, pa asnjë lloj qëllimi konkret, por thjesht, sepse ata janë viktimat të një pasioni negativ, prej të cilit e kanë shumë të vështirë të heqin dorë.

Lidhur me këtë aspekt, Imam Khomeini (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) ka thënë: “Të gjithë ata që janë njohur me librin “Xheuahirul Kelam”, janë të vetëdijshëm për sasinë e madhe të thashethemeve dhe shpifjeve të fabrikuara për dijetarët dhe muxhtehidinët tanë të mëdhenj. Të gjithë ata që e kanë lexuar atë libër, e kanë të qartë sasinë e thashethemeve dhe të intrigave të thurura për këto figura shumë të nderuara të Islamit, prej rrugaçëve që janë rritur rrugicave pa dritë, të atyre imoralëve, që kanë për qëllim të prishin dhe të dëmtojnë rëndë imazhin e dijetarëve tanë të nderuar.”³⁴

³⁴ Shkëputur prej librit të Imam Khomeinit, “Keshful Esrar”.

Shpejtësia në gjykim dhe në shkrim

Në disa raste, një pjesë e mendimtarëve dhe e intelektualëve bie në kurthin e këtyre thashethemeve, pa ndonjë qëllim të lig, apo ndonjë prapavijë të vetëdijshme paragjyquese. Kjo dukuri ndodh shpesh, sepse këta intelektualë nuk kanë sasinë e duhur të informacioneve dhe nuk e ndjekin ngjarjen apo lajmin me intensitetin dhe seriozitetin e nevojshëm.

Lidhur me këtë kategori njerëzish, Imam Khomeini (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) hedh dritë dhe thotë: “Është një kategori e njerëzve të ndriçuar me dije. Është një kategori e njerëzve të ditur të shkollave dhe të universiteteve. Është një kategori e caktuar e intelektualëve që kanë një formim për t’u pasur zili dhe një pjesë e studentëve të këtyre universiteteve që kanë qëllime të mira dhe dëshira të tilla. E lus Allahun e Madhëruar, që t’i ndihmojë dhe t’i mbështesë ata me ndihmën dhe mbështetjen e Tij të madhe. Për këtë kategori intelektualësh dhe njerëzish të mençur kam një qortim të sinqertë prindëror. Shumë prej tyre, kur shkruajnë rreth dijetarëve, rreth dijeve të ndryshme të Islamit apo rreth dispozitave të ndryshme të tij, rreth jurisprudencës islame, vërej se janë paksa të shpejtuar në gjykimet e tyre. Ndonjëherë ndodh që, pa dashur, ata të japin gjykime të gabuara, lidhur me çështje

të caktuara. Jam thellësisht i bindur se tek e gjitha kjo nuk qëndron asnjë prapavijë e vetëdijshme qëllimkeqe. Jam besimplotë, gjithashtu, se pjesa më e madhe e angazhimeve të tyre vihet në funksion të ndihmesës ndaj Islamit dhe të myslimanëve. Jam i bindur se shkrimet dhe gjykimet e tyre të shpejtuara nuk kanë asnjë qëllim të dyfishtë negativ, por kjo vjen si rezultat i mungesës së një informacioni të plotë të lidhur me këto çështje.³⁵

Duhet të jemi vigjilentë dhe të bëjmë kujdes lidhur me këto dukuri.

Lidhur me këtë pjesë, Imami i nderuar (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) thotë kështu: “Jeni të rrethuar me armiq të shumtë, që vijnë prej kategorive dhe shtresave të ndryshme të popullsisë. Janë të shumta planet dhe strategjitë e ndërtuara për t’ju dhënë ju dhe hauzeve të dijes, goditjen përfundimtare. Kjo është një prej ëndrrave më të mëdha dhe më të thella, që e shohin dhe e synojnë armiqtë e Islamit dhe të vendit tuaj.”

³⁵ Shkëputur prej një fjalimi të shkëlqesisë së tij, më 30.11.1977., pas martirizimit të djalit të tij të madh, Es Sejid Mustafa. “Sahifet Nur”, vëll. 1, f. 158.

KAPITULLI I KATËRT

ÇËSHTJE, RRETH TË CILAVE QËNDROJNË PIKËPYETJE TË MËDHA

Janë disa çështje të rëndësishme, të lidhura me mënyrën e funksionimit të hauzeve të dijes, si dhe me çështjet e mënyrës së sigurimit të jetesës në to. Njerëzit kanë pyetje dhe dilema të ndryshme dhe, si gjithmonë, Imam Khomeini (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) është aty për të sqaruar për njerëzit me transparencën më të plotë dhe për t'i dhënë përgjigje të gjitha pyetjeve, hamendësimeve dhe dilemave që ata kanë, cilado qoftë natyra e tyre. Imami i nderuar ka qenë vazhdimisht ndjekës në afërsi i çështjeve të terrenit dhe për këtë arsye ka qenë gjithmonë pranë pikëpyetjeve të njerëzve dhe dilemave të tyre të ndryshme. Gjatë fjalimeve të ndryshme që ai ka mbajtur, me urtësinë dhe me mençurinë e tij, ai ka mundur që, nëpërmjet një terminologjie të përzgjedhur me shumë kujdes, të sjellë për

njerëzit përgjigjet e duhura, duke mundur kësisoj të largojë prej mendjeve të tyre pikëpyetjet dhe dilemat e tyre të mëdha. Do të paraqesim këtu për lexuesin disa prej këtyre dilemave.

Veçimi dhe përqendrimi vetëm në studim

(studimi pa ndërprerje)

Është një kategori njerëzish, të cilët ua lejojnë vetes të thurin dhe të ndërtojnë prej imagjinatës së tyre, teori nga më të ndryshmet, që lidhen me mënyrën e jetesës, me mënyrën e studimit, me mënyrën e nxënies së dijes dhe me mënyrën e përfitimit të të ardhurave materiale të nxënësve të dijes. E bëjnë këtë derisa mbërrijnë në një përfundim, që thotë: “Është e domosdoshme dhe e nevojshme që nxënësit e dijes, të mos merren vetëm me obligimet e tyre fetare, të lidhura me kërkimin e dijes dhe mbartjen mbi supet e tyre të kësaj përgjegjësie. Përveç këtyre detyrimeve shumë të rëndësishme, ata duhet të merren edhe me profesione të tjera, si për shembull tregtia apo bujqësia apo çdo lloj zanati tjetër, në mënyrë që të nxjerrin bukën e gojës për veten dhe për familjarët e tyre.

Për të gjithë ata që nuk janë të ndërgjegjshëm për mënyrën e nxënies së dijes, për rëndësinë e saj të madhe dhe për përgjegjësinë e ngarkuar mbi supet e atyre nxënësve të dijes ndaj shoqërisë së tyre, ky lloj pretendimi mund të gjejë pranim dhe mund të duket shumë i logjikshëm. Lidhur me këtë këndvështrim, Imam

Khomeini (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) ka një mendim të ndryshëm.

Lidhur me këtë pjesë ai deklaroi dhe thotë kështu: “Ixhtihad do të thotë të merresh me studimin e hollësishëm të të gjitha ligjeve dhe dispozitave të Allahut, të lidhura me tërësinë e aspekteve të jetës individuale dhe shoqërore prej kohës në të cilën njeriu nuk ishte krijuar ende dhe nuk kishte ardhur në këtë botë, e derisa të largohet përfundimisht prej kësaj bote. Kjo çështje dhe ky angazhim është i lidhur me të gjitha veprat, në të gjitha etapat e jetës së njeriut. Një dije e tillë, me të gjitha degët dhe nëndegët e saj, ka nevojë për një studim pesëdhjetë vjeçar. Kur themi pesëdhjetë vjet, nënkuptojmë angazhimin e plotë dhe pa ndërprerje nga nxënia e dijes dhe dhënia e saj.

Të gjithë ata që kanë mundur të lexojnë dhe të njihen me përmbajtjen e librit “Xheuahirul Kelam”, e kanë lehtësisht të konstatueshëm dhe të vërtetueshëm lodhjen dhe përpjekjen e madhe të muxhtehidinëve të nderuar. Këta burra të mëdhenj janë pikërisht ata, rreth të cilëve ngrenë pikëpyetje njerëzit e rrugicave, parazitët, përgojuesit dhe thashethemexhinjtë e ndryshëm. Janë pikërisht këta njerëz parazitë që vijnë për të përcaktuar detyrimet dhe përgjegjësitë e këtyre njerëzve të mëdhenj, që e kanë shkrirë jetën e tyre në rrugën e dijes, të shkencës dhe të përhapjes së fesë së Allahut. Pyetja, që me të drejtë

lind në këtë rast, është: Kjo fe dhe ky legjislacion që na ka zbritur prej Allahut të Madhëruar dhe na ka ardhur prej Profetit të nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*), a mos vallë ka ardhur për t'u zbatuar dhe për t'u vënë në jetë, apo ka ardhur si një grusht letrash të parëndësishme, që vlejnë për të ushtruar trupin dhe mendjen e myslimanit?! Nëse ky Libër i Allahut dhe trashëgimia e Profetit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) ka ardhur për t'u praktikuar dhe për t'u vënë në jetë, atëherë është mëse e nevojshme, që të përfitohen prej tyre të gjitha dispozitat, ligjet, nënligjet, nenet, kodet një për një, deri tek hollësitë më të hollësishme. Duhet të jemi të sinqertë dhe të pranojmë se një punë kaq e madhe ka nevojë për shumë kohë, angazhim dhe impenjim. Le t'i themi të vërtetat ashtu siç janë. Koha e nevojitur për të realizuar një mision kaq të rëndësishëm dhe kaq të shenjtë sa ky, është e gjithë jeta. Pra, një jetë e plotë. Kjo është koha e nevojitur, nëse nxënësi i dijes e merr seriozisht angazhimin e tij dhe është i gatshëm të përballlet me një ngarkesë të madhe si kjo, gjatë gjithë jetës së tij.

Pasi i paraqitëm të gjitha këto argumente dhe tregues të rëndësishëm, që tregojnë natyrën e impenjimeve dhe të angazhimeve të dijetarëve tanë të nderuar, a është e mundur të besojmë se ata kanë mundësi të merren me punë dhe me angazhime të tjera?! A është e mundur, vallë,

që ata të kenë impenjime dhe shqetësime të tjera për të siguruar bukën e gojës dhe të fëmijëve, si p.sh, tregtia apo të ngjashme me të?! A nuk janë këto prej punëve dhe angazhimeve që kërkojnë kohë të plotë?! Askush nuk mund të hedhë dyshime serioze rreth faktit se dy impenjime si këto mund të kryhen njëkohësisht, ose do të heqin dorë prej hauzeve të dijes e kërimit shkencor, ose do të angazhohen me kohë të plotë në punë e tregti dhe do t'i kërkojnë falje Kur'anit Famëlartë. Do t'i kërkojnë falje Profetit të nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) dhe do t'i thonë: "Ne kemi qenë të zënë me punët tona dhe puna nuk ka lidhje me fenë."

Nëse e doni vërtet Kur'anin dhe dispozitat e tij, nëse e doni Profetin dhe hadithet e tij, atëherë duhet të bindeni se dijetarët janë njerëz të ndershëm dhe të devotshëm, të cilët nuk mund të merren me asnjë angazhim dhe me asnjë punë tjetër."³⁶

Është i njohur prej të gjithëve fakti se dija është tekanjoze. Nuk ta jep një pjesë të vetes, nëse nuk ia jep gjithë veten tënde. A nuk është tradhti, që dijetarët tanë të nderuar të heqin dorë prej shkencave të fesë dhe të shpenzojnë kohën e tyre të vyer, duke u marrë me punë të

³⁶ Shkëputur prej librit "Keshful Esrar" të Imam Khomeinit (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*).

kësaj dynjaje?! A është e logjikshme që dijetari i nderuar të shpenzojë kohën e tij të vyer, për të nxjerrë bukën e gojës dhe të heqë dorë prej impenjimit të plotë në kërkim të dijes fetare, për të cilën do të duhet t'i përgjigjet njerëzve?! A mos vallë, do t'u duhet t'u japin njerëzve të thjeshtë përgjigje gjysmake, sepse nuk kanë kohë të merren ashtu siç duhet me çështjet e fesë?!

Lidhur me këtë çështje, kam një qëndrim të qartë dhe të prerë. Nuk është e pranueshme që dijetarët tanë të nderuar, të lenë mënjane njerëzit e etur për t'u njohur me dijet e fesë dhe me dispozitat e saj dhe të merren me angazhime të tjera. T'u shpjegosh njerëzve fenë e Allahut dhe t'i udhëzosh ata në rrugën e Allahut, është shumë herë më e rëndësishme dhe më me vlerë se sa të merresh me çdo lloj angazhimi tjetër, të lidhur me të ngrënit, me të pirit apo me veshjet. Për këtë arsye, imamët tanë të nderuar ua siguronin bukën e gojës dhe jetesën e përditshme nxënësve të dijes. Kjo ndodh për një arsye shumë të thjeshtë dhe lehtësisht të kuptueshme prej çdo logjike normale. Nxënësi i dijes ka për detyrë të mësojë dhe të informohet imtësisht në lidhje me fenë e Allahut dhe me dispozitat e fesë. Ai duhet t'ua mësojë ato njerëzve. Nisur nga sa u përmend më sipër, është e nevojshme që nxënësit e dijes të angazhohen në studime, kërkime dhe hulumtime me kohë të plotë.

Kundërshtitë ndërmjet dijetarëve

Nuk ka dyshim se, lidhur me çështjet themelore dhe më të rëndësishme të fesë, nuk ka dhe nuk mund të ketë kundërshti ndërmjet dijetarëve të nderuar. Por, ndodh, në disa raste, që ndërmjet dijetarëve të ndryshëm të ketë kundërshti në detaje dhe imtësi të parëndësishme të një rëndësie periferike. Raste si këto mund të ngacmojnë habinë e njerëzve. Shumë prej njerëzve nuk e parashikojnë se ndërmjet dijetarëve të nderuar mund të ketë kundërshti të natyrave të ndryshme. Për këtë arsye, shpesh ata ngrenë pyetjen dhe thonë: “Si është e mundur që të ketë kundërshti mes tyre?! Disa të tjerë janë të mendimit se këto kundërshti i përkasin kohëve të fundit dhe se kohë më parë dijetarët kanë qenë dakord rreth të gjitha çështjeve. Shumë prej njerëzve, kur dëgjojnë lidhur me këto kundërshti, mund të ndiejnë një lloj demoralizimi. Ndodh shpesh që një pjesë të thonë: “Ç’po ndodh me dijetarët?! Ku po shkojmë kështu?!”

Kam dëshirë të sqaroj këtë kategori njerëzish dhe të qetësoj zemrat e tyre. Për të realizuar qëllimin tim, ata duhet të dinë dy gjëra shumë të rëndësishme:

E para: Pjesa më e madhe e këtyre kundërshtive është e lidhur me çështje dhe aspekte dytësore të fesë. Ato nuk kanë asnjë lidhje me çështjet e rëndësishme dhe çështjet themelore të fesë. Mund të ndodhë që ata të

kundërshtohen në detaje, të lidhura me mënyrën e faljes së namazit. Do të vëmë re se ata nuk kanë kundërshti, të lidhura me namazin, si bazë e fesë, por mund të kenë mendime të ndryshme për çështje të lidhura me detaje të tjera. Si për shembull, çështja e tesbihëve në rekatën e tretë dhe të katërt. Disa prej dijetarëve janë të mendimit se obligueshmëria e këndimit të tesbihëve është një herë, ndërsa një pjesë tjetër e dijetarëve janë të mendimit se obligueshmëria e tyre është tre herë.

Nëse do t'i referohemi këtij shembulli, për të shpjeguar natyrën e kundërshtive ndërmjet dijetarëve, mund të themi se kundërshtitë ndërmjet tyre, në rastin konkret, nuk janë të lidhura me namazin, si themel dhe si bazë e fesë. Kundërshtitë e tyre nuk janë as të lidhura me numrin e rekatëve të namazeve. Ata nuk kanë pasur asnjë kundërshti, lidhur me shtyllat e namazit dhe kolonat e tij më të rëndësishme, siç janë: qëndrimi në këmbë, rukuja, sexhdja. Mënyra e faljes së namazit është e njëjtë te të gjithë. Kështu, mund të themi se kundërshtitë janë të lidhura vetëm me disa detaje jo thelbësore të namazit. Kundërshtia, në rastin konkret, është aq e vogël dhe e parëndësishme, sa shpesh nuk e vëmë re në namazet tona, nëse kemi praktikuar njërin mendim apo tjetrin.

Së dyti: Këto kundërshti ndërmjet dijetarëve tanë të nderuar nuk janë një dukuri e re. Është mëse e natyrshme që ata të kenë mendime të ndryshme për çështje të

ndryshme, të lidhura me degëzime të caktuara të fesë apo të ritualeve të adhurimit. Për sa kohë do të ketë hulumtime shkencore dhe analiza të mendjeve të ndryshme, natyrshëm do të ketë edhe këndvështrime të ndryshme. Për këtë arsye, konstatojmë se këto kundërshti kanë nisur që ditën e parë kur ka lindur nevoja për të organizuar trashëgiminë fetare në dije dhe hulumtimet e thella lidhur me të.

Imam Khomeini (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) ka hedhur dritë mbi këtë çështje dhe ka thënë kështu: “Po t’i hedhim një sy librave të dijetarëve, do t’i gjejmë ato të mbushura me kundërshti të natyrave të ndryshme, ashtu siç e shpjegojmë edhe më sipër. Shijet e tyre shkencore dhe të komentimit kanë ndikuar që ata të kenë botëkuptime dhe interpretime të ndryshme, lidhur me çështjet sociale, ekonomike, ushtarake dhe politike të fesë. Në raste të caktuara, vërejmë se edhe kur përballemi me konsensus, pra, me çështje rreth të cilave ka një konsensus prej të gjithë dijetarëve, vërejmë se, në lidhje me detaje të caktuara të këtyre çështjeve, kanë ekzistuar edhe kundërshti.

Një fakt tjetër shumë i rëndësishëm për t’u ditur është se në kohët e hershme, çështje të tilla të kundërshtive kanë qenë të pranishme vetëm nëpër libra, madje mund të themi me siguri se kanë qenë vetëm te burimet kryesore të librave të shkruara në gjuhën arabe. Edhe në ato raste, kur njerëz të caktuar kishin dijeni rreth këtyre informacioneve,

ky fakt nuk ngacmonte te ata njerëz ndonjë habi të madhe. Duke iu referuar fakteve të përmendura më sipër, mos vallë, na lind e drejta të themi se këta dijetarë të nderuar janë kundërshtuar për arsye të pasionit të tyre për kundërshti?! A mos vallë, na lind e drejta të mendojmë se ata e kanë bërë këtë për të kundërshtuar urdhrat e Allahut të Madhëruar?! Jo, kurrsesi, nuk mund të ndodhë diçka e tillë. Allahu na ruajt dhe na marrtë në mbrojtjen e tij!”³⁷

³⁷ Shkëputur prej përgjigjes së Imam Khomeinit (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*), të dhënë për Shejh Muhamed Ali El Ensari, 31.10.1988. “Sahifet Nur”, vëll. 21, f. 98.

Kujdesi në trajtimin e zhvillimeve të reja

Njëra prej problematikave kryesore, me të cilat janë përballur dijetarët e kohëve moderne, është globalizmi dhe përpjekja e Perëndimit për të perëndimorizuar gjithçka që ka lidhje me jetën e myslimanëve, zakonet dhe kulturën e tyre.

Lufta e Perëndimit, drejtuar botës islame nuk ka pasur vetëm natyrë ushtarake. Lufta e tyre ndaj myslimanëve është shtrirë edhe në rrafshin kulturor. Ata i kanë ndezur të gjithë motorët dhe kanë hedhur në fushë të gjitha përpjekjet, fuqitë dhe mundësitë e tyre për të përhapur kulturën e tyre. Kanë bërë të mundurën dhe të pamundurën, me të gjitha mundësitë e tyre mediatike dhe propagandistike, për të mbledhur sa më shumë përkrahës dhe mbështetës të ideve dhe të kulturës së tyre. Kjo është realizuar vazhdimisht nëpërmjet gjendjes së formulave të larmishme të eksitimit të masave me arritjet, zhvillimin dhe me zbulimet e tyre të famshme.

Problemi qëndron në faktin se masat e popullatës dhe njerëzit e thjeshtë, e kanë pasur shumë të vështirë të bëjnë dallimin dhe të identifikojnë ndryshimet ndërmjet kulturës shoqërore dhe arritjeve në fushën e industrisë dhe të teknologjisë. Nisur nga ky fakt, malli i importuar prej

vendeve perëndimore nuk ishte më thjesht një instrument i nevojshëm, që i ndihmon njerëzit për të kryer me komoditet të lartë nevojat e tyre të përditshme, por u shndërrua në një mjet propagandistik, i cili përcillte, me të gjitha detajet dhe intesitetin e tij, një kulturë dhe një mënyrë perëndimore të të jetuarit. Ishte një mënyrë indirekte e përdorur për të imponuar te masat popullore kulturën perëndimore. Këto kanë qenë forma dhe instrumente të ndryshme nëpërmjet të cilave ata kanë mundur të ndikojnë në psikologjinë e masave, duke rrëmbyer kështu, në mënyrë të pavetëdijshme, zemrat dhe mendjet e tyre. Kjo ka qenë një prej formave më dinake dhe me të fshehta të rekrutimit të shijeve të njerëzve, duke i transferuar ata nga realitete kulturore të botës islame, për tek realitetet kulturore të Perëndimit.

Dijetarët tanë të nderuar, kanë qenë plotësisht të vetëdijshëm për këtë rrezik që i kanosej shoqërisë islame. Në disa raste, ata kanë qenë kundër disa shfaqjeve kulturore moderniste, për arsyen e vetme se ato kanë qenë pjesë e kësaj propagande, që kishte në thelb konvertimin e mënyrës së jetesës, nga ajo islame në atë perëndimore.

Lidhur me këtë aspekt, Imam Khomeini (*Zotit qoftë i kwnaqur me të!*) ka thënë: “Duhet të jeni të mirinformuar se kundërshtia e disa dijetarëve të nderuar rreth formave të caktuara të zhvillimit apo të qytetërimit, ka qenë e lidhur pikërisht me frikën e atyre dijetarëve për depërtimin e

ndikimit të Perëndimit nëpërmjet kulturës së tij. Kjo frikë legjitime dhe e mirargumentuar e tyre, ka ndikuar që, në raste të caktuara, ata të jenë pak të tërhequr dhe të rezervuar lidhur me forma të caktuara të këtyre zhvillimeve teknologjike. Ata kanë qenë gjithmonë shumë të kujdesshëm dhe të vëmendshëm dhe nuk kanë lejuar kurrësi, që planet e fshehura dhe të mbuluara me etiketa joshëse të kalojnë pa u vënë re. Të gjitha përpjekjet e Perëndimit, për të ndikuar, nuk kanë mundur t'i shmangen skanimit të vëmendjes dhe mençurisë së dijetarëve tanë të nderuar. Në ditët e para të zbulimeve të reja teknologjike, një pjesë e atyre dijetarëve e kanë trajtuar radion dhe televizionin si zhvillime të rrezikshme nëpërmjet të cilave Perëndimi mund të eksportojë dhe mund të imponojë kulturën e tij te shoqëritë myslimane. Kjo ka qenë arsyeja përse disa prej dijetarëve, në ditët e para të këtyre zbulimeve, kanë qenë kundër përdorimit të tyre.”³⁸

³⁸ Shkëputur prej thirrjes së shkëlqesisë, Imam Khomeinit (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*), drejtuar dijetarëve të vendit, më 22.02.1989.

Metodat e studimit dhe të hulumtimit në hauzet e dijes

Gjatë gjithë historisë, hauzet e dijes kanë marrë mbi supe shtjellimin, shpjegimin dhe qartësimin e dispozitave të fesë për të gjithë myslimanët. Ato nuk kanë qenë kurrë të distancuara nga hallet e njerëzve dhe nevojat e përditshmërisë së tyre. Për këtë arsye kemi vënë re se i gjithë interesimi i dijetarëve përgjatë shekujve ka qenë i lidhur me nevojat më të rëndësishme të njerëzve. Ata i kanë dhënë vazhdimisht përparësi, halleve më të mëdha që i kanë munduar historikisht njerëzit.

Me ndryshimin e nevojave të njerëzve dhe me zgjerimin e mundësive të tyre të punësimit u zgjeruan edhe sipërfaqet e përditshmërisë, për të cilat do të duhej të gjendej gjykimi fetar dhe mendimi i fesë. Për këtë arsye ka qenë e nevojshme që hulumtimi i dijetarëve dhe mendimi i tyre të zgjerohet me kalimin e kohës dhe të depërtojë te fusha që mund të mos kenë qenë domosdoshmërisht të pranishme më parë, sipas nevojave të njerëzve.

Me themelimin e Republikës Islamike dhe me përpjekjet e mëdha për të zbatuar ligjin dhe dispozitat e Islamit, në të gjitha sferat e jetës, lindi një nevojë e paprecedentë, për t'u njohur me një sasi dhe larmi të

madhe të dispozitave islame, të lidhura me të gjitha punët dhe angazhimet e shtetit. Për këtë arsye, ishte mëse e domosdoshme dhe e pashmangshme që dijetarët tanë të nderuar të ofrojnë verdiktin e Islamit, lidhur me zhvillimet bashkëkohore dhe moderne. Ishte detyrë e huazes së nderuar të dijes, që të mbushte të gjitha këto boshllëqe dhe të plotësonte të gjitha hapësirat bosh legislative islame.

Është e natyrshme që edhe myslimanët të përfitojnë prej zbulimeve dhe zhvillimeve të ndryshme në shkencë e teknologji. Me apo pa qëllim, disa njerëz ngatërrohen në këtë pikë. Ata mendojnë se ndjekja e ritmit të zhvillimeve të ndryshme dhe veçanërisht të teknologjisë dhe përfitimi prej metodave moderne, që ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës së njerëzve, duhet të ndryshojë njëkohësisht strukturën tonë të të menduarit dhe mënyrën tonë të jetesës. Këta njerëz mendojnë se qëndrimet e dijetarëve dhe format e tyre të argumentimit janë të ngurta, të vjetruara dhe të papranueshme, sepse u ka kaluar koha. Të bindur dhe të vendosur në vërtetësinë e pretendimeve të tyre, këta njerëz përpiqen, njëkohësisht, të imponojnë forma të reja të të menduarit dhe forma të tjera të mënyrës së argumentimit.

Imam Khomeini (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) e ka vënë vazhdimisht theksin mbi domosdoshmërinë e implementimit të shkencës dhe mbi përfitimin prej llojeve të reja të diturisë. Ai ka nxitur vazhdimisht në

implementimin e metodave moderne, në përfitimin prej dijeve, por njëkohësisht ai ka refuzuar në mënyrë të prerë dhe të vendosur ndryshimin e formës së të menduarit dhe të metodologjive të argumentimit nëpërmjet tekstit Hyjnor. Ai ka qenë i prerë në gjykimin e tij se metodologjia më e saktë, më e përshtatshme dhe e pazëvendësueshme ka qenë ajo e dijetarëve të kohëve të para, apo të atyre që janë konsideruar (selefë). Ai ka qenë i mendimit se forma më e përshtatshme e të menduarit dhe e trajtimit të çështjeve të fik'hut ka qenë ajo që quhet "El Xheuahirijeh".³⁹ Ai ka qenë i mendimit se shpërdorimi dhe humbja e kësaj metodologjie është humbje e të gjithë "fik'hut" - "jurisprudencës islame". Të shpërdorosh këtë metodologji, do të thotë të heqësh dorë përfundimisht prej të gjitha këtyre dijeve, të cilat i kemi trashëguar prej dijetarëve tanë të nderuar. Prej atyre dijetarëve, të cilët me mundin dhe me sakrificat e tyre të mëdha, u përpoqën të na e sjellin fenë të pastër e të saktë, ashtu siç e zbriti Allahu i Madhëruar dhe siç e deshi Profeti i nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*).

Le të meditojmë pak rreth fjalëve të Imam Khomeinit (Zoti qoftë i kënaqur me të!) lidhur me këtë çështje.

³⁹ Shenjë dhe fjalë treguese për librin "Xheuahirul Kelam", që është një enciklopedi e jurisprudencës islame, e bazuar në metodologjinë e vjetër.

“Në përfytyrimin tim, nuk gjendet një mënyrë dhe një metodologji më e përshtatshme dhe më e gjithanshme në përfitimin e dijeve të Islamit dhe të Kur’anit, se sa ajo e dijetarëve tanë të parë (e selefëve). Historia e shkencës, e dijes, e kërkimit dhe e hulumtimit të dijetarëve tanë të mëdhenj ka tashmë një moshë njëmijë vjeçare. Ky është argumenti më i qartë, i cili e mbështet pretendimin tonë se këta dijetarë të mëdhenj dhe të nderuar kanë qenë mbrojtësit e dheut, mbi të cilin ka mbirë ky Islam.”

Imami i nderuar thotë gjithashtu:

“I kam përsëritur udhëzimet në mënyrë shumë tw prerë dhe të qartë. Hauzet tona të dijes duhet të ndjekin të njëjtën metodologji të mësimin dhe të hulumtimit me atë të dijetarëve tanë të parë. Pra, duhet të mbrohet mënyra tradicionale dhe në mesin tonë dhe të gjithë myslimanëve duhet të mbesë i njëjti “fik’h” - “jurisprudencë islame”. Nëse do të devijojmë prej “fik’hut” tradicional, do të thotë që e kemi humbur përfundimisht atë. Është detyra më e madhe e të gjithëve ne që ta mbrojmë “fik’hun” - “jurisprudencën” me të njëjtën forcë dhe vendosmëri, me të cilën e kanë mbrojtur dijetarët tanë prej fillimit e deri në ditët e sotme.”⁴⁰

⁴⁰ Shkëputur prej fjalimit të shkëlqesisë, Imam Khomeinit (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*), mbajtur, më 03.02.1982., gjatë takimit me një grup dijetarësh, ligjërues të ditëve të xhumasë, në qytetin e Khorasanit.

Imami i nderuar thotë gjithashtu: “Përsa i përket mënyrës së mësimit dhe metodologjisë së hulumtimit në hauzet tona, jam i mendimit dhe vazhdoj t’i mësoj idesë se duhet t’i mbetemi metodologjisë tradicionale të mendimit, të hulumtimit. Vazhdoj të jem i mendimit se mënyra më e mirë është “ixhtihadi xheuahiri”. Unë besoj dhe gjykoj se mënjanimi i kësaj metodologjie është i ndaluar. Kjo është mënyra më e saktë për të studiuar dhe për të hulumtuar jurisprudencën islame, por kjo nuk do të thotë se fik’hu/jurisprudenca nuk janë të ripërtërishme.”

Në raste të tjera, Imami i nderuar (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) ka thënë: “Nuk ka asnjë pengesë, që të përfitohet prej metodologjive të reja të hulumtimit, sepse ato nuk bien domosdoshmërisht në kundërshti me tradicionalen.

Lidhur me këtë pjesë, ai thotë kështu: “Duhet të mos harrojmë një çështje shumë të rëndësishme dhe ajo është se nuk duhet t’i tejkalojmë normat, themelet, kolonat dhe kufijtë e mirëpërcaktuara të metodologjisë së përthithjes së gjykimit dhe dispozitës fetare prej tekstit Hyjnor. E vetmja mënyrë, që e shoh të arsyeshme, është bashkërendimi ndërmjet ixhtihadit (el xheuahiri), në mënyrë të palëkundur, dhe metodologjive të reja.”⁴¹

⁴¹ Shkëputur prej komentimit të Imamit (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) ndaj një vendimi të Këshillit Konsultativ të drejtorisë së universitetit “El Muderrisin”, Kumm, datë 06.05.1989.

KAPITULLI I PESTË

DETYRIMET E YMETIT KUNDREJT DIJETARËVE

Dijetarët tanë të nderuar nuk e kanë marrë në mbrojtje këtë fe, në mënyrë që ajo të mbetet thjesht, bojë mbi letër. Përpyekjet e tyre të mëdha, për të shpjeguar këtë fe dhe për të sqaruar njerëzit, rreth argumenteve të saj, nuk kanë qenë thjesht për konsum intelektual të përditshëm. Synimi i tyre ka qenë mbrojtja e kësaj feje dhe trashëgimia e mësimave të saj për brezat që do të vijnë, në mënyrë që ato të jenë për ta udhëzuar, udhërrëfim dhe mënyrë jete.

Nuk ka dyshim se përpjekjet e dijetarëve janë ato që e kanë shndërruar dheun e kësaj bote në vend dhe mjedis të përshtatshëm për të mbjellë frytet e Botës Tjetër. Pyetja, që me të drejtë lind këtu, është: Cilat janë detyrimet e myslimanëve, qoftë në rrafshin individual, qoftë në

rrafshin e përgjithshëm, kundrejt këtyre dijetarëve të nderuar?!

Kjo është një mirësi e madhe, që meriton falënderime të veçanta. Më i madhi falënderim dhe më e mira mirënjohje realizohet vetëm duke i vënë në jetë dhe duke i praktikuar këto mësimet të mëdha, që janë edhe fryti i përpjekjeve të tyre. Të gjitha llojet dhe format e nënçmimit janë shprehje e injorimit të fryteve të punës dhe të përpjekjeve të tyre të mëdha.

Shoqërimi me dijetarët

Janë të shumta transmetimet që hedhin dritë mbi rëndësinë dhe domosdoshmërinë e shoqërimit me dijetarët e nderuar. Transmetohet prej Profetit të nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi dhe mbi familjen e tij të nderuar!*): “Ata që i presin dijetarët, është sikur të më kenë pritur mua. Ata që i vizitojnë dijetarët, është sikur të më kenë vizituar mua. Ata që shoqërohen me dijetarët, është sikur të jenë shoqëruar me mua dhe ata që shoqërohen me mua, është sikur të jenë shoqëruar me Zotin.”⁴²

Transmetohet prej Prijësit të Besimtarëve (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) që të ketë thënë: “Jam i habitur prej të gjithë atyre që kanë dëshirë të kenë shumë miq e shokë, se ç’i shtyn ata të mos shoqërohen me dijetarë të mençur, të ndershëm dhe të devotshëm, prej dijeve dhe prej udhëzimit të të cilëve mund të përfitojnë shumë?”⁴³

Në një tjetër transmetim prej prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*), thuhet: “Shoqërohu

⁴² “Mizanul Hikmen”, vëll. 3, f. 2068.

⁴³ “Mizanul Hikmenh”, vëll. 3, f. 2067.

sa më shpesh me dijetarët. Të shtohet dija, të përmirësohet edukata.”⁴⁴

Këto transmetime hedhin dritë rreth dy përfitimeve të rëndësishme që i vijnë njeriut prej shoqërimit me dijetarët:

Përfitimi i parë: Është dituria që ka ky dijetar. Janë të shumta ajetet kur’anore, në të cilat flitet qartë rreth rëndësisë së madhe të përfitimit prej tyre.

Allahu i Madhëruar thotë në Kur’anin Famëlartë:

"هل يستوي الذين يعلمون والذين لا يعلمون"

“Vallë, a mund të jenë të barabartë ata që posedojnë dije dhe ata që nuk dinë?!”

Ndërsa përfitimi i dytë është edukata. Kjo ndodh, sepse roli i dijetarëve nuk është i lidhur vetëm me përfitimin e dijes. Është pjesë e misionit dhe e përpjekjeve të tyre, gjithashtu, që t’u mësojnë njerëzve vlerat e moralit dhe normat e edukatës së Profetit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*).

Mund të shtojmë gjithashtu, përsa i përket transmetimit të Profetit të nderuar (*Paqja dhe begatia e*

⁴⁴ “Mizanul Hikmeh”, vëll. 1, f. 55.

Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!): “Ata që i presin dijetarët, është sikur të më kenë pritur mua. Ata që i vizitojnë dijetarët, është sikur të më kenë vizituar mua. Ata që shoqërohen me dijetarët, është sikur të jenë shoqëruar me mua dhe ata që shoqërohen me mua, është sikur të jenë shoqëruar me Zotin.”, është tregues i qartë se përfitimi prej shoqërimit me dijetarët i tejkalon kufijtë e të mundurës, pasi Allahu i Madhëruar është përfaqësuesi i të mirës absolute. Nisur nga ky fakt, kuptojmë se përfitimi prej shoqërimit me Të është përfitim i të mirës së pakufizuar absolute.

Në transmetimin e mësipërm, qartësisht vihet theksi dhe shoqërimi me dijetarët konsiderohet si shoqërim me Allahun e Madhëruar. Në këtë rast, vihet re lehtësisht se gjithçka e mirë përfitohet prej kësaj shoqërie.

Lukmani i urtë (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) e ka këshilluar të birin e tij: “Biri im! Shoqërohu sa të mundesh me dijetarët dhe ndiq sa të mundesh me gjunjët e tua, gjunjët e tyre në kuvendet e dijes. Allahu i Madhëruar i ngjall zemrat me urtësitë e dijes, ashtu siç e ngjall tokën e vdekur me shiun që e zbret prej qiellit.”⁴⁵

Duhet të jemi të qartë se askush nuk përjashtohet prej kësaj këshille dhe prej këtij amaneti, madje as drejtuesit e lartë dhe njerëzit e veshur me pushtet. Të gjitha transmetimet islame theksojnë se pushtetarët duhet të frekuentojnë selitë e dijetarëve dhe asgjëkund nuk flitet për

⁴⁵ “Mizanul Hikmeh”, vëll. 1, f. 402.

të kundërtën. Në një transmetim prej Imam Sadikut (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*), citohet që ai të ketë thënë: “Mbretërit e ushtrojnë pushtetin e tyre ndaj njerëzve, ndërsa dijetarët e ushtrojnë pushtetin e tyre ndaj mbretërve.”⁴⁶

Po t’i hedhim një sy këshillave dhe udhëzimeve të Imam Khomenit (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*), vihet re qartë se ai nuk përqendrohet vetëm te domosdoshmëria e shoqërimin të dijetarëve, por kërkohet diçka më shumë se kaq. Kërkohet njëkohësisht mbështetja e tyre me të gjitha format, pasi ata janë siguri për vazhdimësinë e Islamit dhe qëndrueshmërinë e tij përballë sfidave të shumta dhe armiqve që e sulmojnë në mënyrë të pandërprerë.

Lidhur me këtë aspekt, Imam Khomeini (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) thotë kështu: “Duhet ta dini mirë se hauzet tona të dijes, janë ato që e kanë mbrojtur Islamin deri tani. Po të mos kishin qenë përpjekjet e këtyre dijetarëve të nderuar, askush nuk do të dëgjonte më për emrin e Islamit dhe për ekzistencën e tij. Ata që e kanë mbrojtur Islamin dhe i kanë dhënë atij jetë në ditët me të zeza të historisë dhe në rrethanat më të vështira të saj, janë dijetarët. Mbështetini dhe përkrahini sa të mundeni ata.”⁴⁷

⁴⁶ “Mizanul Hikmeh”, vëll. 3, f. 2087.

⁴⁷ Shkëputur prej fjalimit të shkëlqesisë, Imam Khomeinit (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*), mbajtur, më 29.02.1979., ditën e kthimit të tij në qytetin e Kummit. “Sahifet Nur”, vëll. 8, f. 67.

Pasojat e mënjanimit të dijetarëve

Shoqërimi me dijetarët është rruga më e sigurt për të udhëtuar drejt Allahut të Madhëruar. Shoqërimi me ta është një kështjellë e sigurt, në të cilën njeriu mund të mbrohet prej vështirësive të jetës dhe rreziqeve të ndryshme të saj. Imam Zejnul Abidin (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) hedh dritë mbi këtë aspekt gjatë lutjeve të përdorura prej tij. Ato lutje janë përfaqësuese të një shkolle të plotë, të lidhur me të gjitha dimensionet e edukimit të njeriut. Në njërën prej lutjeve të tij, citohet që ai të ketë thënë kështu: “Zoti im! Mos vallë, ma ke ndaluar mua shoqërimin me dijetarët dhe e ke bërë këtë shkak të poshtërimit tim?”

Kështu, pra, Imami i nderuar Zejnul Abidi (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) i ka përmbledhur me një fjalë të vetme të gjitha ndikimet dhe pasojat negative që shkaktohen prej largimit të kuvendeve të dijetarëve dhe shoqërimit prej tyre. Ajo fjalë është “poshtërimi”. Nëse Allahu i Madhëruar vendos të na poshtërojë, çfarë mund të na mbetet tjetër?! Zoti ynë! Mos na lër në duart e veteve tona, as sa masa e kohës në të cilën hapet e mbyllet qepalla e syrit.”

Paralajmërim

Është një transmetim i Profetit të nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) te i cili duhet të ndalemi dhe të meditojmë thellësisht. Ky është një hadith, i cili përcjell një paralajmërim të madh dhe të rrezikshëm për të gjithë myslimanët dhe myslimanet, veçanërisht lidhur me këtë krizë që jemi duke përjetuar.

Profeti i nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) thotë: “Do të vijë një kohë për popullin (ymetin) tim, kur njerëzit do të largohen prej dijetarëve ashtu siç largohen dhentë prej ujkut. Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar do t’i sprovtojë myslimanët me këto tre vështirësi:

E para: E ngre bereqetin prej tyre;

E dyta: Allahu do të vendosë mbi ta pushtetarë të padrejtë dhe zullumqarë;

E treta: Do të dalin nga kjo botë pa e besuar Allahun e Madhëruar.”⁴⁸

E lusim Allahun e Madhëruar, të mos jemi prej asaj kohe që nënkuptohet prej këtij hadithi të nderuar.

⁴⁸ “Mizanul Hikmeh”, vëll. 3, f. 2324.

(Kritika) qortimi i dijetarëve

Është e mirënjohur teoria, që thotë se të vetmit që nuk gabojnë, janë ata që nuk punojnë. Pra, ata që nuk bëjnë asgjë. Kjo do të thotë se njeriu që punon, është i ekspozuar ndaj gabimeve dhe të metave, që duhet patjetër t'i korrigjojë. Ky është një segment i pashmangshëm i rrugëtimit të njeriut drejt përsosmërisë. E njëjta gjë vlen edhe për institucionet edhe për shtresat e ndryshme të shoqërisë. Ato janë në gjendje të vazhdueshme përmirësimi dhe përsosmërie.

Kjo përsosmëri i ka themelet mbi kritikën, si një institucion i rëndësishëm i përmirësimit të shoqërisë. Kjo ndodh për një arsye shumë të thjeshtë. Nëse nuk ka kritikë, nuk ekziston as mundësia për të identifikuar gabimet dhe më pas për t'i korrigjuar ato.

E vërteta tjetër është se kjo kritikë, merr vlerën e saj kur adresohet saktë dhe ka ndikim të kundërt, kur nuk adresohet saktë. Madje, në disa raste mund të jetë edhe shkatërruese. Në këtë rast, kritika dhe qortimi është në vetvete një gabim që duhet të korrigjohet. Nisur nga këto të dhëna, mund të themi se kemi dy lloje kritikash. Kritikën konstruktive dhe kritikën shkatërruese. Kjo është një dukuri e natyrshme. Le të marrim rastin e thikës.

Thikën mund ta përdorim për nevoja të prerjes së ushqimeve të ndryshme, me të cilat sigurojmë jetesën. Thikën mund ta përdorim, gjithashtu, edhe për të vrarë dhe për të marrë jetë njerëzish. Kështu, pra, edhe kritika është njëlloj. Atë mund ta përdorim për të mirë dhe për t'u afruar te Allahu i Madhëruar, sikurse mund ta përdorim për qëllime të liga dhe për t'u futur në gjynah.

Përsa i përket kritikave, adresuar hauzes dhe dijetarëve të nderuar të saj, nuk ka dyshim se kritika konstruktive është mëse e nevojshme për rrugëtimin drejt përsosmërisë. Ajo është një lëvizje, e cila nuk mund të ndalet një ditë prej ditëve. Ndalesë, do të thotë ngurtësi dhe mbetje në vend. Lidhur me këtë aspekt, transmetohet prej Imam Kazimit (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*): “Është i humbur ai njeri që i ka dy ditë të jetës së tij të ngjashme me njëra-tjetrën.”⁴⁹

I gjithë problemi qëndron te kritikën shkatërruese, të cilat në vend që të korrigjojnë e të riparojnë, shkatërrojnë gjithçka. Pyetja që lind menjëherë, është: Si të dallojmë të dyja format e kritikave?

⁴⁹ “Mizanul Hikmeh”, vëll. 2, f. 1110.

Kritika konstruktive dhe kritika shkatërruese

Pjesa më e shëndetshme e kritikës është kritika adresuar vetvetes. Transmetohet prej prijësit të besimtarëve, Imam Aliut: “Ata që e mësojnë veten e tyre dhe e edukojnë atë, janë më të meritueshëm për respektin dhe lëvdatat, se ata që i mësojnë të tjerët dhe i edukojnë ata.”⁵⁰

Natyrshëm që kritika konstruktive është pozitive, pasi njeriu nuk do për veten e tij përveçse të mirën.

Autokritika, apo e thënë ndryshe, kritika adresuar vetes, është shumë e rëndësishme, pasi ashtu siç e përmendëm edhe më lart, ajo e ndihmon njeriun dhe qenien në rrugëtimin e saj drejt përsosmërisë. Ky është një proces, të cilin dijetarët tanë të nderuar e kanë praktikuar dhe e kanë vënë në jetë përgjatë historisë. Si e tillë, nuk kishte si të ndodhte ndryshe, pasi edhe Imam Khomeini (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) e ka praktikuar atë vazhdimisht, veçanërisht kur orientimet e tij i adresohen hauzes së dijes dhe dijetarëve të saj. Në raste si këto, kritikën apo sugjerimet vijnë në funksion të përmirësimit të funksionimit dhe të plotësimit të misionit të tyre të shenjtë. Adresimi i këtyre kritikave ndaj hauzes së nderuar është,

⁵⁰ “Mizanul Hikmeh”, vëll. 1, f. 54.

në një farë mënyre, adresim i kritikave ndaj vetes, pasi Imami i nderuar (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) është pjesë e pandarë e hauzes. Sigurisht, që pozicioni i tij i lartë në hierarkinë e hauzes dhe pozita e lartë e “Uilajetit/i parë”, e vesh atë me një lloj autoriteti të atillë, që mund të adresojë kritika apo sugjerime të tilla.

Për të qartësuar dallimin ndërmjet kritikës konstruktive dhe asaj shkatërruese, Imami i nderuar (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) ka përcaktuar disa rregulla dhe norma, nëpërmjet të cilave mund të ndërhyhet për përmirësimin e punës së dijetarëve. Këto norma na prezantohen të shkurtuara në një fjalim, në të cilin ai shprehet: “Në asnjë rast nuk kemi pretenduar se bijtë tanë, që i përkasin kësaj kategorie, janë të gjithë, pa përjashtim, të mirë, të ndershëm dhe të pagabueshëm. Nuk kemi pretenduar kurrë se ata nuk kanë nevojë të përmirësohen e të reformohen, në mënyrën e funksionimit të tyre. Ata janë si të gjitha shtresat e tjera të popullsisë. Ka prej tyre që janë të mirë, siç ka prej tyre që janë jo të mirë. Të këqijtë e tyre janë më të këqij dhe më të dëmshëm se të këqijtë e shtresave të tjera të popullsisë. Mund të themi, gjithashtu, se të mirët ndër ta, janë më të mirë se më të mirët e shtresave të tjera të popullsisë. Janë më të vlefshëm për veten e tyre, për njerëzit, për vendin e tyre, për pavarësinë e vendit. Kam dëshirë të theksoj se përmirësimi apo reformimi i tyre nuk mund të pretendohet të kryhet prej

Rida Khanit, i cili nuk e ka ditur se si shkruhet fjala “Ruhani”. Nuk e ka ditur, nëse shkronja “h ” tek fjala “Ruhani” është “h ه” apo “h ح”. Ata që kanë të drejtën e plotë për të ndërhyrë në një aparat delikat dhe shumë të rëndësishëm si ky, duhet të plotësojnë më parë kriteret e mëposhtme:

1. Duhet të kenë njohuritë e nevojshme fetare, në mënyrë që fjala dhe kritika e tyre të mos jetë injorante dhe e verbër.
2. Duhet të jenë prej njerëzve që i duan dhe i respektojnë dijetarët, sikurse duhet të jenë prej atyre që besojnë se prania e dijetarëve në shoqëri është e domosdoshme dhe e rëndësishme.
3. Duhet ta kenë qëllimin e pastër, që do të thotë se kritika nuk duhet të ketë prapavijë të përfitimeve personale.
4. Të jenë posedues të aftësive mendore, që i kualifikojnë ata në dallimin e të mirës nga e keqja, sikurse lipset që kritika apo ndërhyrja të jetë e ndërtuar mbi një platformë të qartë të mirargumentuar, me qëllimet dhe synimet përkatëse.
5. Të kenë ndikim ndër dijetarët, në mënyrë që të kenë mundësi të realizojnë me sukses ndërhyrjet e tyre.

Këto janë kushte që i plotësojnë dijetarët e shkallës apo të nivelit të parë. Të gjithë ata që nuk bëjnë pjesë te kjo

kategori njerëzish, janë automatikisht të përjashtuar prej çdo mundësie për të ndërhyrë.”⁵¹

Kështu, pra, në fjalën e Imamit të nderuar (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) vihet re qartë se të vetmit njerëz, të cilëve u lejohet të kritikojnë hauzen dhe dijetarët e saj të nderuar, janë dijetarët e nivelit apo të shkallës së parë.

⁵¹ Shkëputur prej librit “Keshful Esrar”, i shkruar prej Imam Khomeinit (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*).

Gabimet individuale

Njëra prej problematikave më të rëndësishme, të ngritura dhe të trajtuara prej Imam Khomeinit (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) është se gabimet e një individi të caktuar nuk duhet dhe nuk mund t'ia faturojnë frymës dhe linjës së përgjithshme të orientimit të dijetarëve tanë të nderuar. Nuk është e pranueshme që të gjykohen të gjithë njëloj dhe mendimi negativ duhet të mbetet vetëm për personin që e ka kryer një vepër negative. Kjo është një frymë dhe një orientim shumë i rrezikshëm, pasi në këtë mënyrë ligjërojmë kritikën, fyerjen dhe përbaltjen e hauzes së nderuar, sa herë që mund të gabojë dikush që mban çallmë në kokën e tij.

Lidhur me këtë aspekt, Imam Khomeini (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) thotë: “Në ato raste kur njerëzit shohin gabime apo të meta te ndonjë prej dijetarëve, nuk do të hedhin fajin vetëm mbi atë që e ka kryer gabimin, shkeljen apo fajin, por do të shikojnë me sy të keq të gjithë dijetarët e tjerë. Do të ishte shumë mirë dhe shumë e drejtë që mendimi i tyre i keq të lidhej vetëm me personazhin që e kryen shkeljen. Njerëzit nuk bëjnë analiza të shumta, kur shohin dijetarët e ndryshëm të gabojnë. Te të gjitha shtresat e punonjësve të administratës, ka gjithashtu njerëz të korruptuar dhe gabimtarë. E njëjta gjë ndodh me

përfaqësuesit e çallmave. Ka prej tyre të ndershëm, shumë ka prej tyre të devijuar. Problemi është se, nëse gabon një shitës dyqani ushqimor, njerëzit thonë se gaboi shitësi i dyqanit. Nëse gabon shitësi i parfumeve, njerëzit thonë se gaboi shitësi i parfumeve. Ndërsa kur gabon një hoxhë, që mban çallmë mbi kokën e tij, njerëzit nxitojnë të thonë se dijetarët janë të këqij. Çallmat janë të këqija. Kjo nuk është aspak e drejtë.”⁵²

Shqetësimi i madh i Imamit të nderuar (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*), lidhur me këtë dukuri negative, shpaloset akoma më i qartë, kur thotë: “Të gjithë ata që e njohin dhe e kuptojnë vlerën e librit “Xheuahirul Kelam”, e kuptojnë se cila është sasia e sakrificave të bëra prej dijetarëve tanë të mëdhenj, që kjo fe të mbërrijë e pastër dhe e paprekur deri në ditët tona. Këta janë dijetarët tanë të mëdhenj, të cilët i kritikojnë disa personazhe anonimë, frekuentues rrugicash e qoshesh. Janë këta njerëz që dalin dhe u mësojnë dijetarëve tanë të mëdhenj detyrat e tyre.”⁵³

⁵² “El Xhihadul Ekber”, fq 10.

⁵³ Shkëputur prej Librit “Keshful Esrar”, me autor Imam Khomenin (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*).

PËRMBYLLJE

DIJETARËT DO TË MBETEN PËRJETËSISHT

Dijetarët tanë të nderuar, kanë pasur ndikim të madh te njerëzit dhe i kanë shtrirë rrënjët e dashurisë së tyre thellë zemrave të njerëzve përgjatë historisë. Ata nuk janë bërë kurrë palë me qeveritë zullumqare dhe me tiranitë e ndryshme, për të shkelur interesat e popullatës së thjeshtë. Kurrë nuk kanë qenë vegla, instrumente dhe pasues pushtetarësh, sikurse nuk kanë qenë kurrë zëdhënës dhe përsëritës të fjalimeve të deklaratave të pushtetit.

Kanë qenë, në vazhdimësi, ndjekës të rrugës së Allahut dhe të linjës së Tij. Ata nuk kanë pasur frikë, përveçse prej Allahut të Madhëruar dhe ky ka qenë një faktor shumë i rëndësishëm që ka ndikuar në hapjen e zemrave të njerëzve dhe në krijimin e një klime të jashtëzakonshme të respektit dhe të vlerësimit në mesin e tyre.

Lidhur me këtë aspekt, Imam Khomeini (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) ka thënë: “Popullariteti i madh i dijetarëve nuk ka ardhur si rezultat i imponimit nëpërmjet fuqisë së shpatës, as nëpërmjet pasurive të shpenzuara, për t’u bërë

atyre reklamë, por ka qenë rezultat i natyrshëm i singeritetit dhe i devotshmërisë së tyre. Kjo i ka shtyrë njerëzit dhe i ka nxitur ata që të zgjedhin dijetarët si drejtues të punëve të tyre më të rëndësishme.”⁵⁴

Nuk ka dyshim se vazhdimësia e këtyre hauzeve është ngushtësisht e lidhur me “gajbin” - “të panjohurën” dhe historia është argumenti më i qartë, i lidhur me këtë. Po ta mendosh thellë, e gjithë sasia e përndjekjes, e persekutimit dhe e masakrimit të ushtruar ndaj hauzes së nderuar dhe dijetarëve të saj përgjatë shekujve, ka qenë e përmasave të atilla, që mund ta shuanin përfundimisht ekzistencën e tyre. E gjithë kjo sasi përndjekjeje dhe persekucioni, mund të ndikonte që hauzes të mos i ekzistojë më as emri, po të mos kishte qenë përkujdesja e madhe e Allahut të Madhëruar dhe ndërhyja e fuqishme e mekanizmave të së padukshmes hyjnore. Ishin këto mekanizma ato që ndikuan në çmontimin e formulës së vrasjes dhe të zhdukjes. Ishin këto mekanizma që ndikuan në vazhdimësinë e ekzistencës.

Transmetohet prej prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*): “Dijetarët do të vazhdojnë të jenë të pranishëm, për sa kohë do të zgjasë koha dhe do të ketë jetë mbi tokë. Të mëdhenjtë e tyre do të mungojnë,

⁵⁴ Shkëputur prej thirrjes së Imamit të nderuar (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*), drejtuar një grupi dijetarësh myslimanë të vendit, mbajtur, më 22.02.1989.

ndërsa të ngjashmit e tyre do të jenë të pranishëm te zemrat e njerëzve.”⁵⁵

Në një tjetër transmetim të ardhur prej prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) lexojmë: “Dijetarët do të jenë të pranishëm, për sa kohë do të ekzistojë nata dhe dita.”⁵⁶

Po të shmangim ndërhyrjen e mekanizmave të së padukshmes hyjnore dhe mbështetjen e tyre, do të vëmë re gjithashtu se Allahu i Madhëruar e kishte përgatitur terrenin dhe kushtet, për vazhdimësinë e këtyre hauzeve të nderuara përgjatë shekujve.

Lidhur me këtë aspekt, Imam Khomeini (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) thotë: “Zhdukja e hauzeve është një çështje plotësisht e pamundur. Ajo do të vazhdojë të ekzistojë edhe në të ardhmen, në të njëjtën formë që ekziston edhe sot. Përveç dimensionit Hyjnor, në mbështetjen e ekzistencës dhe të vazhdimësisë së hauzeve të nderuara, mund të themi me plot gojë, se vazhdimësia e tyre është e lidhur njëkohësisht edhe me të tjera ekuilibra natyrorë dhe objektivë. Kjo, sepse të gjithë myslimanët, veçanërisht shí’itët janë shumë të interesuar për vazhdimësinë dhe ekzistencën e tyre. Janë popujt ata që e mbështesin praninë e atyre hauzeve dhe ata që e marrin mbështetjen e tyre prej

⁵⁵ “Mizanul Hikmeh”, vëll. 3, f. 2068.

⁵⁶ Burimi i njëjtë, i mësipërm.

popullit, nuk ka qeveri e as tirani që t'i ndalojë. Askush nuk ka fuqi të përballet me fuqinë e popullit. Qeveritë janë të përkohshme. Ato shkojnë e vijnë në periudha shumë të shkurtra kohore.”⁵⁷

Mbrojtja e këtyre hauzeve, duke iu përmbajtur origjinalitetit të funksionimit të tyre, është përparësi mbi të gjitha përparësitë, pasi ajo është e vetmja siguri për mbrojtjen e Islamit ndërmjet njerëzve dhe për vazhdimësinë e rrugës së vërtetë.

Çdo lloj ndryshimi ekuilibrash, që mund të ndodhë mbi tokë, apo çdo lloj disfate, që për arsye dhe rrethana nga më të ndryshmet mund ta pësojmë (Mos e thëntë Zoti!), nuk mund të na dëmtojë strategjikisht. Prania e hauzeve në mesin e shoqërisë myslimane është siguria e vetme për rikthimin e gjithçkaje, siç ka qenë më parë dhe për rikuperimin e çdo lloj disfate apo humbjeje të mundshme përgjatë historisë. Është mirësia dhe begatia e atyre dijetarëve të nderuar, përfaqësuese e rrënjëve të mirësisë, që do t'i çelë frytet e saj me kalimin e kohës.

Nga ana tjetër, nëse mbetet çdo arritje kështu siç është dhe humbim dijetarët tanë të nderuar, atëherë kemi

⁵⁷ Shkëputur prej fjalimit të shkëlqesisë, Imam Khomeinit (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*), mbajtur, më 10.01.1972., në kohën kur regjimi irakian i përzuri dijetarët dhe shkollarët iranianë nga qyteti i Naxhafit të nderuar.

humbur Islamin dhe rrugën e drejtë. Në këtë mënyrë do të humbim gjithçka. Nuk ka dyshim se dijetarët tanë të nderuar janë truri i çdo pune dhe truri i qenies njerëzore. Ata janë bërthama, thelbi, esenca dhe rrënja e mirësisë. Nëse eliminohet bërthama, kemi eliminuar gjithçka tjetër rreth saj.

Lidhur me këtë aspekt, Imam Khomeini (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) thotë: “Edhe sikur Islami të humbasë gjithçka, edhe sikur të humbasë në të gjitha rrafshet (Mos e thëntë Allahu!), nëse mbetet mbi tokë, qoftë edhe një dijetar i vetëm, sipas mënyrës tradicionale dhe ndjek me përkushtim rrugën e drejtë, gjithçka mund të rregullohet. Ndërsa në ato raste kur Islami fiton gjithçka dhe realizon qëllimet e tij, por humb dijetarin tradicional, humb “fakihun” e shkollës së të parëve të ndershëm (të selefëve), është e pamundur vazhdimësia në rrugën e drejtë, kështu që ai devijon prej saj dhe më pas humbet gjithçka. (Mos e thëntë Zoti!).”⁵⁸

⁵⁸ Shkëputur prej thirrjes së Imam Khomeinit (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*), drejtuar popullit iranian, me rastin e katërvjetorit të triumfit të Revolucionit Islamik, mbajtur, më 11.02.1983.

PËRMBAJTJA

Parathënie.....	5
Hyrje.....	7
KAPITULLI I PARË	
POZITA E DIJETARËVE.....	15
Prej nga buron kjo pozitë e tyre?!	29
KAPITULLI I DYTË	
NDIHMA E DIJETARËVE PËRGJATË HISTORISË.....	30
Dimensioni shkencor në historinë e dijetarëve.....	31
Dimensioni luftarak dhe i përpjekjeve në historinë e dijetarëve.....	41
Këta dijetarë nuk janë një përjashtim.....	44
KAPITULLI I TRETË	
SHËNJESTRIMI I DIJETARËVE.....	46
Shënjestrimi i tyre prej pushtuesve.....	48
Infiltrimi i agentëve në mesin e dijetarëve.....	52
Dashuria për të mirat materiale të kësaj bote.....	55
Thashethemexhinjtë.....	57
Shpejtësia në gjykim dhe në shkrim.....	58
KAPITULLI I KATËRT	
ÇËSHTJE RRETH TË CILAVE QËNDROJNË PIKËPYETJE TË MËDHA.....	60

Veçimi dhe përqendrimi vetëm në studim (studimi pa ndërprerje).....	62
Kundërshtitë ndërmjet dijetarëve.....	67
Kujdesi në trajtimin e zhvillimeve të reja.....	71
Metodat e studimit dhe e hulumtimit në hauzet e dijes....	74
KAPITULLI I PESTË	
DETYRIMET E UMETIT KUNDREJT DIJETARËVE.....	79
Shoqërimi me dijetarët.....	81
Pasojat e mënjanimi të dijetarëve.....	85
Paralajmërim.....	86
(Kritika) Qortimi i dijetarëve.....	87
Kritika konstruktive dhe kritika shkatërruese.....	89
Gabimet individuale.....	93
Përmbyllje.....	95
Dijetarët do të mbeten përjetësisht.....	95

اسم الكتاب: مكانة العلماء في فكر الإمام خميني

المترجم: الحاج ولنت مريا

التدقيق: صبريه فزا

التصحيح الأدبي: يريدا كولا

التصحيح اللغوي: ويولسا كاراي

الايخراج النهائي و تصميم الغلاف: صبريه فزا

ناشر: جمعية النسيم - تيرانا - ألبانيا